

LEXMARK
LEGAL

PO MENDONI TË EMIGRONI NË MB DHE JU
DUHEN KËSHILLA TË SIGURTA LIGJORE?

JENI NË VENDIN E DUHUR!

Ekipi ynë i avokatëve të specializuar në emigracion ofron
asistencë profesionale për:

- Aplikime për viza
- Çështje azili
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Apeli kundër dëbimit
- Shtetësi britanike

Ne ju mbështesim me përkushtim dhe
transparencë në çdo fazë të procesit.

E ARDHMJA JUAJ NË MB FILLON ME
VENDIMIN E DUHUR.

Kontaktoni Lexmark Legal sot – ekspertët
që ju qëndrojnë pranë në çdo hap.
Partneri juaj i besueshëm në emigracion.



- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488

Ashley House 235 - 239
High Road, Wood Green,
London N22 8HF

www.lexmarklegal.com

The **Albanian**

VITI I 23 I BOTIMIT 10 MAJ 2026

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

**STARMER PREMTON VEPRIME
MË TË GUXIMSHME NDËRSA SHTOHEN
KËRCËNIMET NDAJ LIDERSHIPIT TË TIJ**



PETRIT KUÇANA

**DREJTORËT E
BASHKISË DHE
INVESTITORËT
E DIASPORËS...**



ARBEN MANAJ

**LABURISTËT PËSUAN
HUMBJE TË MADHE
NË ZGJEDHJET LOKALE,
KRYEMINISTRI STARMER:
NUK E JAP DORËHEQJEN**


**A KA SHQIPËRIA
NJË POLITIKË
TË JASHTME?**

DITMIR BUSHATI




**LETËRSIA
E KUJTIMEVE
DHE NARRATIVA E PËRVOJAVE**

EMIN AZEMI



**MODELI I ANALIZËS
SË TË ENJTES
MBRËMA**

IRENA BEQIRAJ



**'VRASËSIT ME
LIÇENSË TË QYTETIT'**

SONILA MEÇO



**USHTRIME MENDORE
PËR POLIKRIZA,
NGA NJË VEND MESDHEU**

VETON SURROI



Rashid A.Khan Solicitor (Principal) Mob: 07774222062 190 MERTON HIGH STREET WIMBLEDON, LONDON SW19 1AX



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths




The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Ka qenë goxha e përshtjelluar ideja e përcaktimit të investitorit strategjik. Madje duket se pikërisht ky përshtjellim ,ka qenë mbulesa perfekte e asaj që ndodhte ose po ndodh, përtej fasadës propagandistike.

Janë të paktën tre raste që lakuriqëzojnë çdo tentativë manipuluese për investitorët strategjikë. Së pari ishte një i akuzuar nga drejtësia si pjesë e grupeve krimi-

nale por që çuditërisht ishte bërë investitor strategjik në bregdetin verior të vendit.

Vazhdohet akoma me përdredhjet e ish-deputetit, pra burrit të ministres, që u zgjodh gjithashtu investitor strategjik, madje siç aludohet, duke përfituar në mënyrë të padrejtë edhe tokën e komshisë.

Madje besohet se burri i ministres, si investitor strategjik çoi në pranga edhe ish-kryetarin e bashkisë Himarë. Po të thella paskërkan qenë këto punë...

Rasti i fundit (që duket edhe më i pështiri) janë disa drejtorë të bashkisë së Tiranës, që jo vetëm krijuan kompani dhe merrnin vetë projekte miliona eurosh, (pra i caktonin vetë, i selektonin vetë, i merrnin vetë).

Kaq brutalisht qenë kërkua vjedhur në Bashkinë e Tiranës?!

Sikur të mos mjaftonte kjo, këta tipat drejtorë, apo drejtorë të drejtorëve (firma quhej 5D) çuditërisht paskërkan marrë edhe statusin e investitorit strategjik në Durrës. Përparësitë e investitorit strategjik që nuk paguan taksa për 10 vite, nuk kishte sesi të mos përputheshin me drejtorët e bashkisë së Tiranës që janë pas hekurave.

Dyshohet se miliona euro të përvetësuar (vjedhura) nga bashkia e Tiranës janë investuar në projektet strategjikllëke të bregdetit.

Mbase nuk është shumë me vend që të pyetet edhe sa të tjerë mund të jenë, që nuk kanë rënë akoma në rrjetën e drejtësisë, por besohet se çdo qytetar shqiptar më banim jashtë republikës, mbetet i shokuar nga bëmat e këtyre investitorëve strategjikë, e këtyre drejtorëve, që rezultojnë se kanë një pagë tejet modeste, diku 700 euro (pse marrin edhe rrogë?!)

Po sikur këta drejtorë të ishin nga diaspora?

Nga ata specialistët që drejtojnë apo menaxhojnë biznese dhe kompani me renome ndërkombëtare, që kanë dëshmuar aftësi të jashtëzakonshme drejtimi dhe menaxhimi? Shumë i mirë për të qenë e vërtetë...

Po përsenuk përfshihet Diaspora, qoftë edhe në investimet strategjike?

Nuk përzgjidhen, apo nuk qasen? Ka një problem të madh; Nuk rekomandohen as nga patronazhistët as nga aktivistët, pra nuk do të mund të sjellin vota në sëndukun e partisë.

Nëse do i referoheshim kryeministrit, kur shprehej se sistemi i bën njerëzit, mbetet tejet retorike çdoloj pyetje për sistemin. E madje madje do të shkohej edhe më tej tek vota e diasporës.

Akoma nuk janë regjistruar shqiptarët e diasporës?

Akoma nuk ka një listë të PHD-ve shqiptarë, pra doktorëve të shkencave?

Akoma nuk ka një listë biznesesh shqiptarët të diasporës?

Apo nëse këta do të vinin të investonin çdo të bëhej me pjestarët e kimit që gdhien investitorë strategjikë, me burra apo gra ministrash, aq më keq me ata drejtorë që e kishin zët t'u merrte kush projekte tor i bënin vetë i përzgjidhnin vetë, i merrnin paratë vetë dhe gdhieshin me kostumin e shtrenjtë të investitorit strategjik.

A mund të bëhet të paktën sa Kosova?

ribotim 10 prill 2024

Discover The Latest Trends in Technology

Dotech
website

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



The Albanian

L E X M A R K
L E G A L

DËSHIRONI TË JETONI, PUNONI APO STUDIONI NË MB?

Ne ofrojmë shërbime të specializuara imigrimi, të përshtatura sipas rrethanave tuaja.

Ekipi ynë profesionist ju udhëzon në çdo hap, duke e bërë procesin e imigrimit të qartë, të sigurt dhe pa stres.

SHËRBIMET TONA PËRFSHIJNË:

- Viza për punëtorë të kualifikuar
- Viza studimi
- Viza për bashkëshort dhe familjarë
- Viza Global Talent & Inovative
- Punonjës fetarë
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Shtetësi britanike
- Apelime dhe rishikime vizash

Ne ju ndihmojmë me këshillim profesional, përgatitje dokumentesh dhe mbështetje të plotë gjatë aplikimit.

Na kontaktoni sot për një të ardhme më të sigurt në Mbretërinë e Bashkuar.

Ekspertë të besuar të imigracionit.



- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488



Ashley House 235 - 239
High Road, Wood Green,
London N22 8HF

ARBEN MANAJ

Deri dje mendohej se laburistët do humbinin keq në zgjedhjet lokale të 7 majit, por që laburistët në pushtet të përfundonin partia e tretë në shkallë vendi për nga vendet e fituara në pushtetin lokal, dhe të dalin partia e tretë në Skoci, është thjesht e paimagjinueshme, vetëm dy vjet pas fitores spektakolare në zgjedhjet e përgjithshme.

Fituesit e vërtetë të këtyre zgjedhjeve janë partia “Reforma”, e populistit Nigel Farage, ndërkohë konservatorët kanë hapur kapakun e arkivolit të tyre politik, kur mendohej se do ishin të vdekur por të pakallur. Kryeministri laburist Starmer, është duke përjetuar Starmagedonin e tij politik, edhe pse ka deklaruar se nuk do largohet nga posti. Por është reagimi i deputetëve të tij në grupin parlamentar ai që ka më shumë rëndësi për avënin politik të kryeministrit, pasi në fund të fundit ata janë gjykatësi, juria edhe ekzeku-

tori i kryeministrit laburist dhe e ardhmja e tij në fund të fundit është në duart e tyre.

Zgjedhjet lokale bënë që laburistët të humbasin deri më tani thujse gjysmën e vendeve, ndërkohë partia “Reforma” e Farage arrin fitore masive për të dytin vit radhazi, me dyfishin e vendeve në pushtetin lokal se laburistët. Vota në rang vendi duket se e vendos partinë e Brexit-it, çka realisht është, në kuotën e 27 për qind të votës në shkallë vendi, dhe konservatorët e qendrës së djathtë në 20 për qind, ndërkohë laburistët në vend të tretë.

Laburistët kanë humbur më keq në zonat elektorale që dikur kanë qenë bastionet e tyre në rajonet industriale, dhe vota në radhët e klasës punëtore

është historikisht për Partinë Laburiste, ose në shqip, Partinë e Punës. Laburistët humbën Uellsin në zgjedhjet rajonale, një bastion që e kanë kontrolluar prej 100 vjetësh. Ndërkohë janë të tretët në Skoci.

Sistemi dypartiak në Britani është shkërmoqur këtë të premtë në testin më të rëndësishëm të opinionit publik, përpara zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2029, ku pak besojnë se laburistët do shkojnë me të njëjtin lider, kryeministrin aktual, i cili sipas sondazheve të opinionit publik, kryeministri Starmer rezulton me mbështetjen më të keqe për të gjithë liderët e Britanisë deri më sot.

LABURISTËT PËSUAN HUMBJE TË MADHE NË ZGJEDHJET LOKALE, KRYEMINISTRI STARMER: NUK E JAP DORËHEQJEN



Kryeministri britanik, Sir Keir Starmer, pritet të premtë veprime më të guximshme për të përballuar “sfidat e mëdha” të vendit, ndërsa përballat me presion në rritje nga deputetët e Partisë Laburiste që po vënë në dyshim udhëheqjen e tij.

Në një fjalim të rëndësishëm të planifikuar për të hënë, Starmer do të përpiqet të rifillojë mandatin e tij politik pas humbjeve të rënda në zgjedhje, të cilat kanë nxitur thirrje të reja për dorëheqjen e tij.

Një numër në rritje deputetësh laburistë kanë dalë publikisht gjatë fundjavës duke kërkuar largimin e tij. Ndërkohë, rivalja e mundshme për udhëheqjen, Angela Rayner, deklaroi se partia duhet të bëjë më shumë për të fituar mbështetjen e votuesve, të cilët janë goditur nga rënia e standardeve të jetesës.

Situata u tensionua më tej pasi deputetja Catherine West paralajmëroi se mund të nisë procedurat për të shkaktuar një garë për lidërshiptin, nëse fjalimi i Starmer nuk e bind.

Deputetja nga veriu i Londrës tha për BBC Radio 5 Live se do të tërhiqej nga përpjekja për sfidimin e tij vetëm nëse Starmer do të mbante një fjalim që “e frymëzon kombin” dhe ofron një plan bindës për rikthimin e besimit ndaj partisë.

Megjithëse West ka sqaruar se nuk synon vetë postin e kryeministrit, iniciativa e saj mund t’u hapë rrugën kandidatëve të tjerë potencialë si ish-zëvendëskryeministrja Angela Rayner dhe ministri i Shëndetësisë Wes Streeting. Edhe kryetari i bashkisë së Manchesterit të Madh, Andy Burnham, shihet si rival i mundshëm, por ai do të duhet fillimisht të rikthehet si deputet për të kandiduar.

STARMER PREMTON VEPRIME MË TË GUXIMSHME NDËRSA SHTOHEN KËRCËNIMET NDAJ LIDERSHIPIT TË TIJ



Fjalimi i së hënës konsiderohet si një nga momentet më vendimtare të kryeministrisë së Starmer deri më tani, pas rezultateve katastrofike në zgjedhjet e fundit, të cilat e kanë bërë pozicionin e tij politik më të brishtë se kurrë.

Në qendër të mesazhit të tij pritet të jetë synimi për ta vendosur Britaninë “në zemër të Europës”, përmes lidhjeve më të ngushta me Bashkimin European. Starmer beson se një afrim

i tillë mund të forcojë ekonominë, tregtinë dhe mbrojtjen e Mbretërisë së Bashkuar.

Gjithashtu, ai pritet të theksojë se programi legjislativ i qeverisë për vitin e ardhshëm, i cili do të prezantohet në Fjalimin e Mbretit të mërkurën, do të sjellë “shpresë, urgjencë dhe qartësi mbi interesat që qeveria përfaqëson”.

Sipas fragmenteve të publikuara nga Downing Street, Starmer do të deklarojë:

“Do të përballemi me sfidat e mëdha dhe do të bëjmë debatet e mëdha. Përballë problemeve të vendit, ndryshimet graduale nuk mjaftojnë.”

Ai do të shtojë se qeveria ka nevojë për një përgjigje më të fortë në fusha si ekonomia, mbrojtja, Europa dhe energjia, duke argumentuar se “këto nuk janë kohë të zakonshme”.

Rayner: Laburistët kanë “shansin e fundit”

Në një deklaratë të gjatë të dielën, Angela Rayner paralajmëroi se Partia Laburiste mund të jetë në “shansin e fundit” për të rindërtuar marrëdhënien me votuesit që po vuajnë nga kostoja e lartë e jetesës.

Ajo kërkoi masa të menjëhershme për uljen e kostove për familjet, mbështetje për bizneset lokale, rritje të pagës minimale dhe më shumë pronësi publike e komunitare në sektorë të ndryshëm.

Rayner gjithashtu mbështeti rikthimin e Andy Burnham në Parlament, duke argumentuar se partia kishte gabuar kur e pengoi të kandidonte në një zgjedhje të pjesshme në shkurt.

Humbjet zgjedhore tronditën Laburistët

Partia Laburiste humbi afro 1,500 këshilltarë lokalë në zgjedhjet në Angli, ndërsa partia Reform UK e Nigel Farage fitoi terren të konsiderueshëm. Edhe Partia e Gjelbër arriti të tërhiqte një pjesë të mbështet-

jes tradicionale të laburistëve në Londër dhe zona të tjera urbane.

Laburistët humbën gjithashtu pushtetin në Uells, ku kishin dominuar politikën për një shekull, ndërsa në Parlamentin Skocez fituan vetëm 17 nga 129 vende — rezultati i tyre më i dobët ndonjëherë në zgjedhjet për Holyrood.

Më shumë se 30 deputetë laburistë kanë kërkuar publikisht që Starmer të japë dorëheqjen ose të përcaktojë një afat për largimin e tij.

Megjithatë, rregullat e partisë e bëjnë të vështirë nisjen e një gare për lidërshiptin, pasi një kandidat duhet të sigurojë mbështetjen e të paktën 81 deputetëve laburistë — një e pesta e grupit parlamentar aktual.

Ndërkohë, mbështetësit e Andy Burnham shpresojnë që çdo garë të shtyhet derisa ai të ketë mundësinë të rikthehet në Parlament, megjithëse deri tani asnjë deputet nuk ka pranuar të lirojë vendin për të.

Situata komplikohet edhe më shumë për Angela Rayner, e cila dha dorëheqjen nga posti i zëvendëskryeministres shtatorin e kaluar, pasi doli në pah se kishte paguar më pak taksë prone për një apartament me vlerë 800 mijë paund në Hove.

Ajo ende pret rezultatin e një hetimi nga HMRC, gjë që mund të pengojë çdo fushatë të menjëhershme për lidërshiptin.



**HARINGEY
HOSPITAL**

Shërbime Shëndetësore Private në Londër për Komunitetin Shqiptar

E njëjta klinikë e besuar — tani **Haringey Hospital**
(i njohur më parë si Medipark Clinic)

URGJENCA

MJEKU I FAMILJES (GP)

MJEKË KONSULTANTË

IMAZHERI & LABORATOR

ANALIZA GJAKU

KLINIKË DENTARE

FARMACI

Shërbim në gjuhën shqipe

- Mjekë specialistë
- Teknologji moderne
- Kujdes profesional

Komuniteti shqiptar në Londër na beson.



573–575 Green Lanes
Harringay Ladder, London N8 ORL



0208 341 3185



+44 7947 785174



www.haringeyhospital.com

IRENA BEQIRAJ

MODELI I ANALIZËS SË TË ENJTES MBRËMA !

Çdo të enjte mbrëma, nëse ke durim edhe asgjë tjetër më interesante për bërë, në ekranet shqiptare bisedat nuk janë thjesht pa kuptim- qëllimi i tyre është të jetë i pakuptimta.

Por, hërë pas here vendos t' i shoh, për tu kujtuar se në çfarë lloj vendi jetoj; për të mos harruar se kush supozohet të ketë sukses dhe pse; edhe për tu habitur sesi kultura e kultit të individit i trajton të gjitha sistemet sikur të ishin një identitet, në vend që ti vendosin ato herë pas here në dyshim si struktura.

Mjafton një pult edhe një ekran, edhe të enjten mbrëma, çdokush kupton që politika në këtë vend nuk ka lidhje me idetë aq më pak me të vërtetën, përkundrazi ajo është e lidhur pazgjydhshëmrisht me individin dhe marrëdhëniet ndërpersonale, ku rreshtimi tregon besnikëri dhe kritika pabesi.

Të enjteve mbrëma, mediokriteti me përpjekjen e tij kokëfortë, kërkon të na imponohet për ta pranuar si normal faktin që partitë politike nuk mund të jenë asasi organizata ku debatohet por, thjesht një formë komploti për të marrë pushtetin.

Ky konstrukt shfaqet së pari në gjuhë. Besnikëria kërkohet, dhe pasojat për thyerjen e saj janë të menjëhershme dhe publike.



Ajo është e vetmja monedhë e vërtetë, ndaj mbrojtja dhe fuqia rrjedhin përmes besnikërisë edhe jo përmes meritës.

Në ekranin kësaj të enjteve mbrëma, deputetët e rinj edhe analistët e vjetër, u përpoqën të shmangin vëmendjen nga çështja thelbësore "organizimi diktatorial

partiak " duke e drejtuar atë tek qëllimet individuale, tek karakteri, personaliteti e shkuara e tashmja e individit .

Ky model fenomeno logjik i analizës i cili fillon me fjali të tipit - "Oh , Ben Blushin të gjithë e njihnin

Ditmirin po ashtu ! Të lutem mos më fol për Mamicën e Skënderbeut"

me dashje apo pa dashje gjithmonë arrin në të njëjtin konkluzion "vetëm lideri që ngrihet në mëngjes e bie në gjumë në darkë duke falenderuar partinë (siç tha një deputete dje) " është i duhuri për t'u përkrahur edhe mbështetur .

Më modelin e analizës së të enjtes mbrëma , e cila bëhet pastaj mënyrë arsytimi popullore , lista e përgatitur e armiqve nuk është vetëm një

listë emrash , por është një listë historish, interesash , lidhjes, vesesh, ankesash, dyshimesh . Me anë të kësaj metode analize jo vetëm kontrollohet korniza e argumentit por nuk lejohet që askush të merret me problemin bazë edhe vdekjeprurës për demokracinë :

"Ne jetojmë në një kulturë ku e vërteta bëhet dytësore besnikëria parësore edhe në kultura të tilla pushteti nuk mbahet përmes transparencës ose llogaridhënies, por përmes presionit, frikësimit dhe kontrollit të rrëfimit"

E pra, nuk duhet të kishte pikë rëndësie nëse ky problem i vërtetë edhe me pasoja për të gjithë artikulohe si rrjedhojë e inatit të Elisës , pakënaqësisë së Ditmirit , mbrojtjes së Ahmetajt apo interesave të Blushit .

Kjo pikënisje është e rëndësishme vetëm për ata që nuk duan të ndryshojnë status quo-në , por që janë në kërkim të dëshpëruar të një tjetër diktatori , dhe në këto kushte ky që kemi u rezulton gjithmonë më i mirë .

Sot ka rendësi të heqim e ta flakim kostumin madhështor edhe tragjik të moralit të remë, I cili na qepet çdo të enjte mbrëma , për ti hapur rrugë ndryshimit

Dotech

website 

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545



The Albanian

NJË VENDIM MË I DOBISHËM SESA I RREZIKSHËM

Të zvogëlosh kompetencat e prokurorëve represivë, që të plasim në burg pa fakte dhe me indiferencën e plotë të gjyqtarëve, përbën realisht një minirevolucion.

Dhe kjo gjë ia vlen edhe kundrejt çmimit të lartë të shpëtimt të Lalit apo Belës

ANDI BUSHATI

Ndonëse vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të zbutur masat e paraburgimit në Shqipëri është disafish i paragjykuar, ai përbën një akt në të mirë të qytetarëve dhe të së ardhmes.

Le ta nisim fillimisht me dyshimet. Ndryshimi i praktikës së deritanishme gjyqësore lidhur me masat më të rënda të sigurisë për të arrestuarit, ka nxitur frikën se po ndërmerret për të nxjerrë nga burgu Veliajn, Beqajn, Metën, etj. Si i tillë ai mban mbi vete pandehmën se është i motivuar politiki.

Së dyti, ai ka përkuar me një kohë kur parlamenti shqiptar refuzoi t'i hapë rrugë kërkesës së SPAK, për të hequr imunitetin e Belinda Ballukut, duke shtuar akuzat se po mbyllet epoka e shkurtër e "fundit të pandëshkueshmërisë", e cila ishte edhe një nga kollonat kryesore që motivoi reformën drastike në drejtësi.

Më tej, rastësisht ose jo, ai qëlloi në kulmin e fushatës propagandistike të iniciuar nga Edi Rama, i cili për in-



teresa thëllësisht personale, u kujtua të citojë raportet ndërkombëtare, që i nxinin rekordet e Shqipërisë si një vend ku kishte më shumë të paraburgosur sesa të dënuar me vendim të formës së prerë.

Qoftë për të penguar që një ditë prangat të viheshin mbi kyçet e tij, apo qoftë edhe për të shpëtuar ata pak ushtarë që i kanë mbetur të lirë, kryeministri u angazhua në këtë kryqëzatë duke shndërruar në kryefjalë të sulmeve të tij kundër SPAK-ut

dhe gjykatave mentalitetin represiv të trashëguar nga e kaluara, për të të plasur me të parën brenda.

Po ta ndërlidhësh këtë qëndrim politik edhe me faktin se Gjykata e Lartë është treguar kryesisht vasale e pushtetit politik në vendimet e saj të mëdha, dyshimet nuk kanë se si të mos shumfishohen.

E megjithatë, megjithatë, pavarësisht nga këto pandehma ogurzeza, ajo çka kanë vendosur sot Kolegjet e Bashkuara, mbetet një akt që duhet

përhëndetur.

Duke marrë shembullin e një fshatari të thjeshtë lezhian, Bektesh Zenelit, që në kotecin e pulave iu gjet hashash, por për të cilin mbajtja si i paraburgosur dukej e ekzagjeruar, G.J.L. ka vendosur se për të shpënë dikë në burg, shkallët më të ulëta të gjykimit duhet të shtojnë filtrat.

Këtej e tutje ato nuk duhet të mjaftohen me formulat standart se i pandehuri përbën rrezikshmëri, se mund të prishë provat apo mund të arratiset. Por në të kundërt atyre u shtohet obligimi që të marrin në shqyrtim edhe masat më të lehta madje të shprehur me vendim se përse nuk i kanë aplikuar ato.

I shpjeguar me një gjuhë të thjeshtë vendimi udhëzon që arresti me burg të pushojë së qeni një rregull dhe të shihet si përjashtim.

Ai gjithashtu e shton barrën e dyshimit ndaj kërkesave të prokurorisë dhe kërkon një rol më të madh kontrollues të gjykatave ndaj pretendimeve të organit të akuzës që në praktikë merrshin deri më tani si të padiskutueshme.

E thënë në mënyrë të përmbledhur, ky vendim mund të përkthehet si hapja e

një epoke të re, ku burgjet tona duhet të jenë të populluara me shumë më pak banorë që nuk kanë një vendim të formës së prerë. Dhe pikërisht këtu qëndron lajmi i mirë, pasi ky hap është një avancim ndaj standartit të prezumimit të pafajsisë dhe konsolidimit të respektimit të të drejtave të njeriut.

Në këtë kuptim, sado motive politike që ta kenë shtyrë Sokol Sadushin ta iniciojë këtë proces, sado i rrejtshëm të ketë qenë meraku për Bektesh Zenelin, sado rrezik që të ketë ajo që dyshon opozita se gjithçka po bëhet për lirimim e mundshëm të Veliajt apo pengimin e arrestimit të Ballukut, shtrirja e efekteve të këtij vendimi prek fatet e aq shumë njerëzve, sa në këtë rast kazuset personale të disa pushtetarëve janë krejtësisht të papërfillshme.

Të zvogëlosh kompetencat prokurorëve represivë që të plasim në burg pa fakte, të përkrahur nga pandëshkueshmëria dhe indiferenca e plotë e gjyqtarëve, përbën realisht një minirevolucion.

Dhe kjo gjë ia vlen edhe kundrejt çmimit të lartë që mund të ketë shpëtimi i Lalit apo Belës.



ARBEN MALAJ

"Asnjë ministër nuk mund të vazhdojë gjatë duke fshehur kokën si struci dhe duke mos dhënë përgjigje për pyetje konkrete. Bastet sportive vazhdojnë të 'gëlltisnin' qindra milionë euro. Ministria e Financave shkel ligjin duke mos nxjerrë aktet nënligjore përkatëse, ndërsa qindra miliona shkojnë tek pronarët realë të basteve sportive.

Kjo nuk është paafësi, por rrezik i lartë i influencimit të grupeve kriminale në politikën fiskale, përderisa pranohet dhe theksohet masivisht se politika shqiptare është e kapur nga krimi. Ky rast duhet të hetohet nga SPAK sa më parë. Ka aq shumë analiza thëllësisht profesionale në mediat e shkuara dhe vizive, sa i mjaftojnë SPAK-ut për të hetuar me prioritet një

BASTET SPORTIVE VAZHDOJNË TË 'GËLLTISIN' QINDRA MILIONË EURO

burim kriminal me qindra milionë euro."

Ministria e Financave nuk publikon listën e përfituesve nga ulja me fuqi prapavepruese e tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%.

Po ashtu, Ministria e Financave nuk jep asnjë të dhënë të detajuar mbi përfituesit nga paqja fiskale, ndërkohë që statistikën e borxhit janë lehtësisht të analizueshme.

Ato përpunohen përmes tabelave Excel dhe funksioneve analitike si Pivot Tables, të cilat mundësojnë identifikimin dhe grupimin e të dhënave sipas kategorive të ndryshme, përfituesve, shumave dhe periudhave kohore.

"Lidhur me justifikimin e shitjes së naftës për jahtet luksoze, shpjegimi i Ministrisë së Financave është analfabetik; ata duhet ta lexojnë, ta kuptojnë dhe ta zbatojnë Konventën e Vjenës sipas sqarimeve thëllësisht profesionale të mëposhtme.

Përgjigjia pas pyetjeve të mia thëllësisht profesionale: Pa dashur të bëj komente, po ndaj me ju sqarimin e IA-së për këtë debat dhe për këtë rast: Konventa nuk krijon detyrim për asnjë vend që t'u shesë jahteve luksoze karburant me përjashtim nga taksat."

Keni të drejtë kur thoni se "djalli qëndron në detaje", pasi përdorimi i Konventës së Vjenës në këtë kontekst është shpesh një **interpretim i zg-

jeruar që vendet e përdorin për të joshur turizmin luksoz, por që BE-ja po e lufton gjithnjë e më shumë.

1. Konventa e Vjenës: Detyrim apo Mundësi?

Konventa e Vjenës (kryesisht ajo për Marrëdhëniet Diplomatike ose ajo për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave) nuk i "detyron" shtetet të japin naftë falas për jahtet private turistike.

Miti i Detyrimit: Nuk ka asnjë traktat ndërkombëtar që i detyron shtetet të subvencionojnë karburantin për një jaht privat që përdoret për qejf (leisure).

*Praktika Ndërkombëtare: Ajo që ndodh është se jahtet trajtohen si "anije në lundrim ndërkombëtar". Sipas ligjeve detare, nëse një mjet lëshon portin e një shteti për të shkuar në një shtet tjetër, karburanti konsiderohet "furnizim për eksport" dhe si i tillë nuk ngarkohet me taksë lokale.

Abuzimi: Shumë vende (përfshirë Shqipërinë në këtë rast) e përdorin këtë klauzolë për të lejuar jahtet të mbushen pa akcizë, edhe nëse ato lundrojnë vetëm pak kilometra jashtë ujërave territoriale dhe kthehen sërish, duke e përdorur këtë si "karrem" për të sjellë pasanikët në portet e tyre.

2. Përvojat e BE-së kundër "Biznesit Abuziv"
Vendet e Bashkimit Evropian kanë kaluar nëpër procese të ashpra gjyqësore në Gjykatën Evropiane të Drejtë-

sisë (ECJ) pikërisht për këtë çështje. Rasti i Italisë dhe Francës: Për vite me radhë, këto vende lejuan jahtet që merreshin me qira (charter) të mos paguanin akcizë, duke i klasifikuar si "anije tregtare".

BE-ja ndërhynte duke deklaruar se **vetëm anijet që kryejnë aktivitet të mirëfilltë tregtar (transport mallrash ose pasagjerësh me pagesë) përfitojnë nga përjashtimi.

Jahtet private, pavarësisht madhësisë apo "elitarizmit", duhet të paguajnë taksë të plota.

Greqia: Pas krizës financiare, Greqia shtrëngoi rregullat. Edhe anijet turistike duhet të provojnë një numër minimal ditësh lundrimi jashtë vendit për të përfituar lehtësi, duke vendosur sisteme GPS për të monitoruar nëse jahti thjesht "doli dhe u kthye" për naftë të lirë.

Kroacia: Ka aplikuar tarifa të rrepta mjedisore që balançojnë përfitimin që jahtet marrin nga karburanti, duke u siguruar që "elita" të kontribuojë në arkën e shtetit.

3. Diferenca me Fermerët: Një Kontradiktë Politike

Në vendet e BE-së (si Gjermania, Franca apo Greqia), nafta për bujqësinë (**Gasoline for Agriculture**) është prioritet strategjik.

Në BE, fermerët marrin naftë me ngjyrë të kuqe ose jeshile (me taksë minimale ose zero) direkt në pompë

ose përmes rimbursimit të menjëherëshëm.

Logjika e BE-së:

Subvencionimi i fermerit ul koston e ushqimit për popullatën (interes publik). Subvencionimi i jahtit ndihmon vetëm pronarin e jahtit dhe operatorin e portit (interes privat).

Djali" në Shqipëri

Në dokumentin që keni marrë, pika ku thuhet se qeveria ul akcizën me 20% vetëm nëse çmimi kalon 220 lekë/litër për shkak të "krizës në Ngushticën e Hormuzit", është një **mekanizëm mbrojtës për tregun, por nuk adreson faktin pse jahtet (që kanë fuqi blerëse gjigante) marrin naftë me 0 akcizë, ndërsa fermeri (që prodhon bukën) pret radhën për skema rimbursimi që shpesh nuk mbulojnë as 50% të nevojave të tij.

Përfundim:

Nuk ka detyrim nga Konventa e Vjenës për turizmin. Ky është një vendim sovran i qeverisë shqiptare për të favorizuar një sektor (marinat luksoze) në dëm të të ardhurave të shtetit dhe në pabarazi të plotë me sektorin prodhues (bujqësinë).

A mendoni se kjo rritje e sasive të naftës pa akcizë në tabelë (nga 4 në 8 milionë kg) mund të jetë një indikator i "pastrimit" të naftës në tregun e brendshëm përmes mjeteve detar

ARMAND SHKULLAKU

Pas shfaqjes së fundit të Erion Velisë, ata që vuajtën më shumë emocionalisht nga sulmet kundër Robert Ndrenikës, ishin pak a shumë ata që po vuajnë materialisht nga mungesa e kryetarit dorëlëshuar të bashkisë.

Duke shmangur thelbin e atij inskenimi, që la pas një shije të thartuar, një grusht mbështetësish nga halli të Velisë, u përpoqën t'i japin atij trajtat e viktimës nëpërmjet ndjeshmërisë që ngjallte një burrë në moshë të thyer, për më tepër një personazh i dashur i kinemasë e teatrit, i vënë menjëherë nën breshërinë e rrjetit.

Dhe kjo tentativë nuk është se nuk ia arriti qëllimit. Regjisori i pjesës teatrale, "Puthja në ballë" u la mënjanë dhe thujse të gjithë u morën me atë që gjithë jetën e ka shkruar duke luajtur rolet që i kanë caktuar. Prirja jonë popullore për të ndëshkuar pasojën dhe jo shkakun, shkëlqeu edhe një herë në shkronja e ekrane.

Fama e Ndrenikës, mu për këtë i përzgjedhur për të "puthur atë burrë", tërhoqi mbi vete gjithë polemikat post festival. Është i njëjti mentalitet që dënon më fort bashkëpunëtorin e sigurimit dhe jo atë që e detyron të bëhet i tillë, që denigron atë që shitet dhe veneron atë që e blen, që sulmon atë që përulet dhe respekton atë që e godet.

Në këtë kompleks popullor nënshtrimi ndaj pushtetit dhe histerie ndaj dobësisë njerëzore, u godit edhe Ndrenika duke lënë mënjanë autorin e shfaqjes së shëmtuar.

Në sfidën mes pushtetit dhe intelektualit, sigurisht që duhen treguar me gisht edhe ata që keqpërdoren, shiten

Deputeti shqiptar në Serbi, Shaip Kamberi, ka ngritur alarmin lidhur me rikthimin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak në Serbi, duke sjellë në vëmendje, se 135 shqiptarë humbën jetën në rrethana të dyshimta gjatë shërbimit në Armatën Popullore të Jugosllavisë (APJ). Sipas Kamberit, kujtesa kolektive e shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe Kosovë vazhdon të dominohet nga rastet e ushtarëve shqiptarë që u vranë gjatë viteve '70 dhe '80, ndërsa autoritetet jugosllave i klasifikonin ato si "vetëvrasje", "aksidente" apo "shkelje disiplinë".

Ai thekson se familjet e viktimave shpesh raportojnë gjurmë dhune në trupat e të rinjve të kthyer nga ushtria, ndërsa mungesa e hetimeve të pavarura dhe transparencës ka shtuar dyshimet për motive etnike dhe politike pas këtyre vrasjeve. Kamberi deklaroi se shqiptarët në ish-Jugosllavi përballëshin me diskriminim sistematik brenda ushtrisë, sidomos pas demonstratave të vitit 1981 në



apo shërbejnë me vetëdije, për dëmin që i shkaktojnë shoqërisë. Por në rastin konkret, ata që u morën me Ndrenikën ranë pikërisht në kurthin e projektuar për të amnistuar atë që kishte shpërndarë rolet. Si ata që u revoltuan me aktin publik të aktorit 83 vjeçar si ata që u shtirën se u vinte keq për të, në fund shmangën thelbin e atij teatri në sallën e gjyqit.

Pavarësisht trajtave karikaturale të vënies në skenë, debati që do duhej të prodhonte ajo ngjarje është ai i raportit mes pushtetit dhe asaj pjese të shoqërisë që prezumohet në antagonizëm me të, si avangardë e progresit, e lirive më të mëdha dhe e të drejtave më të shumta.

Ata që morën në mbrojtje Ndrenikën

nuk thanë asnjë fjalë për deformimin e vazhdueshëm që Veliaj me pushtetin e tij u ka bërë artistëve, gazetarëve, sportistëve, e në përgjithësi krijuesve, që pikërisht për shkak të sistemit të korruptuar të vlerave që ka instaluar soji i erionveliajve, nuk ia dalin të jetojnë me punën e tyre apo të pleqërojnë me dinjitet nga djersa e shpërblyer.

SHAIP KAMBERI NGRE ALARMIN NË PARLAMENTIN SERB, KËRKON HETIM PËR 135 SHQIPTARËT E VRARË NË ARMATËN JUGOSLLAVE

Kosovë, kur shqiptarët trajtoheshin si "element separatist" dhe të pabesueshëm për shtetin federativ.

Në reagimin e tij, ai kritikoi faktin që Serbia asnjëherë nuk ka pranuar zyrtarisht përgjegjësi për këto raste dhe nuk ka hapur hetime institucionale mbi vdekjet e shqiptarëve në APJ. Sipas tij, arkivat ushtarake vazhdojnë të mbeten të mbyllura, ndërsa tema është lënë jashtë diskutimit publik dhe historiografisë serbe.

Për këtë arsye, Kamberi ka propozuar

formimin e një Komisioni të posaçëm parlamentar që do të hetojë rastet e vdekjes së 135 shqiptarëve në radhët e APJ-së gjatë viteve '80. Ai kërkon që në këtë komision të përfshihen edhe organizata për të drejtat e njeriut, ekspertë të drejtësisë tranzicionale dhe përfaqësues të komunitetit shqiptar. Sipas Kamberit, pa zbardhjen e këtyre rasteve dhe pa ballafaqim serioz me të kaluarën, rikthimi i shërbimit të detyrueshëm ushtarak në Serbi do të vazhdojë të shihet me mosbesim nga shqiptarët e Luginës së Preshevës



Nuk u përmendën emra të tjerë të mirënjohur që për shkak të varësisë nga ky pushtet i kalbur janë detyruar të shpërndajnë supë, të ngulin pemë. Të bëjnë deklarata publike kundër opozitës e të rreshtohen në fondacionet medemek kulturore të Ajola Xoxës.

Zërat publikë që u mallëngjyen nga puthja në ballë e u revoltuan për sulmet ndaj Ndrenikës, nuk bënë asnjë ditë vetme llogarinë e thjeshtë se sa krijues do të jetonin me dinjitet sikur në vend të supës të ndanin qindra mijëra eurot që zonja e parë e bashkisë i kishte investuar në garderobën personale.

Apo sikur paratë e ndara me zarfë në shërbim të propagandës, të shpërndaheshin me garë e transparencë për të mbështetur pikërisht pavarësinë e artistëve ndaj trysnisë së pushtetit.

Shfaqja "Puthja në ballë" nuk duhet analizuar për dobësinë njerëzore të Ndrenikës por duhet parë si një metaforë ulëritëse i kapjes që një pushtet i korruptuar i ka bërë asaj që do duhej të ishte pjesa më progresive e shoqërisë. Jo thjesht për aktin e një aktori të mirënjohur, por për mënyrën se si u trajtua ky akt në sferën e debatit publik.

Njësoj si në rastin e dosjes së Veliajt, ku anashkalohet krimi për t'u kapur personalisht me një prokuror, edhe në këtë rast amnistohet regjisori për t'u marrë me një aktor.

ENDE NUK KENI NJË WEBSITE?

ENDE NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

Dotech
website 

ADRESA E ZYRAVE
30 Avenons Road
London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929
Mob:073 4066 5946
Mob:078 5997 7545

SONILA MEÇO

Edhe aty kullë?“, pyeti me zë të mekur ime bijë mikeshën e familjes që i tregoi se vendin ku mësoi biçikletën dhe i gëzohet ende argëtimit në natyrë do të duhet ta përshëndesë një herë e mirë. Aty së shpejti do të bëhen kulla 28-katëshe.

“Po si? Kush? Sa e mundur është?“, pyeste vajza ime me zërin që treste energji pas çdo pikëpyetjeje.

“Aty ka gjelbërim, s’ka makina, s’ka parkim, mund të vraposh dhe luash pa frikë. Ç’patën? A kthehet? Të protestojmë, a bën dot Syri diçka?“, kthehej nga unë thujse e përlotur, sepse ia njoh lidhjen shpirtërore që krijon me vendet ku ndërton kujtime.

As 24 orë s’kaluan nga trishtimi i saj dhe yni bashkë me të, gjersa na plan-dosi tragjedia e Durrësit.

Dy engjëj humbën jetën duke luajtur futboll në atë copëz shesh mes makinash të parkuara, ndanë një rrugë makinash, mbi betonin e mjerë të një lagjeje fatkeqe. Një tjetër po lufton për të jetuar e Zoti ia lehtësoftë betejën. Nuk kam fjalë ngushëlluese për prindërit e shokët. Nuk kam...

Por s’ka si mos të kem revoltë.

Lagjet e qyteteve tona janë bërë kurthe të tmerrshme ku nuk hyn dot as

Shqipëria ka normën më të lartë të martesave në Europë. Sipas Eurostat, në vitin 2024 u regjistruan 6,8 martesave për 1 mijë banorë, e njëjta normë si në vitin 2022, shumë më e lartë se mesatarja europiane prej 3.9.

Në vend të dytë është Maqedonia e Veriut, por të dhënat e fundit nga ky shtet i përkasin vitit 2021. Mungojnë të dhënat për Kosovën që ka një popullsi të re dhe numër të lartë martesash. Në rajon, niveli më i ulët i martesave është në Serbi, me 4.6 martesave për 1000 banorë.

Pas Shqipërisë, normat më të larta bruto të martesave janë regjistruar në Turqi, me 6,6, dhe Moldavi, me 6,1. Në Shqipëri, norma e martesave ka qenë relativisht e lartë në vitet 1980-1990, duke arritur kulmin në vitin 1990, me 8,9 martesave për 1 000 banorë. Pas kësaj periudhe, vihet re një rënie graduale.

Nga ana tjetër, divorcet në Shqipëri janë bërë më të zakonshme krahasuar me të kaluarën. Në vitin 2024, norma ishte 2,0 divorce për 1 000 banorë, ndërsa në vitin 1964 ishte vetëm 0,6, çka përfaqëson një rritje prej rreth 233%.

Kulmi u arrit në vitin 2019, me 2,1 divorce për 1 000 banorë. Norma e divorceve është mbi mesataren europiane, që rezultoi 1.6 në 2024-n.

Shqipëria u rendit e 11-a për numrin

'VRASËSIT ME LIÇENSË TË QYTETIT'



polic, as mendje e kthjellët, as durim. Aty ku duhej domosdoshmërisht të qe shteti përpos kulturës qytetare, pushteti ia ka dorëzuar ligjit të xhunglës “rregullin” bashkëjetues.

Njerëz që hakërrehen e mallkojnë sho-shoqin për një vend parkimi, topa fëmijësh nën rrota makinash, shoferë të droguar, kalimtarë të çoroditur hallesh, lagje me kulla pa asnjë distancë higjienike, pa një logjikë e plan

urbanizimi që rregullon marrëdhëniet mes përdoruesve të hapësirës publike. Sepse aty ku duhet të ketë trotuar, ka parkim, aty ku duhet të ketë parkim ka kantier ndërtimi, aty ku duhet të ketë park lojërash ka pallat, aty ku duhet të ketë rrugë ka karrige që zënë vend për parkim, aty ku duhet të ketë ndalim qarkullimi ka “licencë” për vrasje me shpejtësi 120 km/h.

Hyni në çdo lagje të Tiranës, e të tjera qyteteve të mbipopulluara. Geto të tmerrshme nga ku veç Zoti të nxjerr pa telashe si të jesh këmbësor e si të jesh vozitës. Shqiptarët vënë bast me koeficient shumë të lartë për jetën sapo nxjerrin këmbën nga shtëpia.

Ndaj tragjedia e Durrësit të shqyen brinjët, sepse është një bast i fituar nga vdekja e mallkuar me koeficient shumë të ulët në një vend ku standardet e jetës janë të negociueshme, ku rrugët nuk garantojnë siguri, ku kantieret nuk mbrohen si duhet, ku hapësira publike është përçudnuar, ajri të vret ngadalë, uji të helmon më shpejt, ushqimet të marrin në qafë, trafiku të nxin jetën, betoni të ze

diellin, krimi të mbyll derën.

E në kulm të dhimbjes, publikimi i pamjeve të tragjedisë është i pa-pranueshëm, skandaloz, i dënueshëm. Cenon dinjitetin, nuk i shton asgjë të vërtetës. Është vrasje gjakftohtë për së dyti, mungesë torturuese empatie. Por nuk mund të zërë gjithë vëmendjen. Videoja është shkelje etike.

Por ajo që prodhon tragjedi është shkelje sistemike.

Dhe këtu nuk ka barabajtje, njëra kërkon përgjegjësi profesionale, tjetra kërkon përgjegjësi publike.

Nëse e gjithë energjia jonë shkon tek dënimi i publikimit, ndërsa kushtet që e bënë të mundur tragjedinë kuturisen në tre ditët e çudisë, atëherë nuk kemi mbrojtur as dinjitetin e viktimave, as jetën e atyre që rrezikohen nesër.

Sonte kemi natë të gjatë përpara, duke kontrolluar shpesh paqen në gjumin e fëmijëve tanë, kapur në një ndjenjë bashkëfajësie në një tragjedi të paralamëruar, me “tolerancën” dhe indiferencën tonë ndaj autorëve të vërtetë të saj.

SHQIPËRIA PO HYN NË DHJETË VENDET E EUROPËS ME MË SHUMË DIVORCE



e lartë të divorceve në raport me popullsinë në 2024-n. Duke përfshirur vendet baltike, që kryesojnë për divorcet në raport me popullsinë, me treguesin për 1000 banorë nga 4 në Moldavi dhe 2.5 në Lituaninë e 2.1 në Estoni, Shqipëria renditet e pesta në Europë, pas Danimarkës (2.1), Turqisë (2.2), Finlandës (2.1) e Suedisë (2.1). Vendet baltike kanë norma të larta divorceesh kryesisht sepse divorci është më i pranueshëm shoqërisht, më i lehtë ligjërisht dhe gratë kanë më shumë pavarësi ekonomike.

Në Shqipëri, shifrat më të fundit të INSTAT tregojnë se numri i martesave ka rënë në nivelin më të ulët historik, ndërsa divorcet kanë marrë drejtim të kundërt, duke arritur kulme që nuk janë parë kurrë më parë. Viti 2024 shënon minimumin historik me vetëm 16 120 martesave, nga rreth 29 mijë në 1990-n.

Në të kundërt divorcet janë rritur. Në 2024-n kishte gjithsej 4800 divorce, nga rreth 2700 në 1990-n. praktikisht në vend një e treta e martesave nuk

arrin të zgjasë “derisa vdekja ti ndajë”.

Në Europë, fqinjët italianë, ku ka shumë shqiptarë emigrantë, praktikisht nuk po martohen më. Italia kishte treguesin më të ulët për martesat për 1000 banorë, në vetëm 2.9, ose më shumë se gjysma e Shqipërisë. Martesat janë të ulëta dhe në fqinjin tjetër Greqi (3.5), ku jetojnë më shumë se gjysma e emigrantëve shqiptarë.

Më pak martesave, më pak divorce. Sipas Eurostat, në BE u realizuan rreth 1,7 milion martesave dhe rreth 0,7 milion divorce në vitin 2024. Në raport me popullsinë, këto shifra janë 3,9 martesave për çdo 1 000 persona dhe 1,6 divorce për çdo 1 000 persona.

Që nga viti 1964, viti i parë për të cilin ka të dhëna, norma bruto e martesave në BE është ulur me më shumë se 50% në terma relativë, nga 8,0 për 1 000 persona në vitin 1964, në 3,9 në vitin 2024. Tendencën rënëse është ndërprerë nga disa rritje të përkohshme në vitet 1989, me 6,4 për 1 000 persona; 2000, me 5,2; 2007, me 5,0; dhe 2018, me 4,5.

Rënia e konsiderueshme e vërejtur midis viteve 2019, me 4,3 për 1 000 persona, dhe 2020, me 3,2, në normën bruto të martesave mund të interpretohet si efekt i pandemisë COVID-19, duke përfaqësuar një ulje prej pothuajse 25%. Që atëherë, është vërejtur një rritje e lehtë e normës bruto të martesave, e cila vlerësohet në 3,9 në vitin 2024.

Gjatë së njëjtës periudhë të gjatë, norma bruto e divorceve pothuajse është dyfishuar, duke u rritur nga 0,8

për 1 000 persona në vitin 1964, në 1,6 në vitin 2024. Norma e divorceve arriti kulmin në vitin 2006, me 2,1 për 1 000 persona, dhe që atëherë ka ardhur duke u ulur lehtë.

Në vitin 2024, Malta kishte normën më të ulët të divorcit në BE, me 0,9 divorce për 1 000 banorë, e ndjekur nga Sllovenia dhe Rumania. Ndërsa normat më të larta u shënuan në vendet baltike, kryesisht në Letoni dhe Lituaninë, si dhe në Estoni, Finlandë dhe Suedi.

Një pjesë e kësaj rritjeje mund të shpjgohet me faktin se divorci u legalizua në disa vende të BE-së gjatë kësaj periudhe, si për shembull në Itali, Spanjë, Irlandë dhe Maltë.

Fillimi i pandemisë COVID-19 duket se ndikoi edhe në normën e divorceve, gjë që shihet nga rënia e lehtë midis viteve 2019 dhe 2020. Megjithatë, ulja e normës bruto të divorceve ishte shumë më pak e theksuar, rreth 10%, sesa ajo e normës bruto të martesave. Që atëherë, kjo vlerë ka mbetur pothuajse e pandryshuar./ Monitor

FERDINAND DERVISHI

A është duke u formësuar në Durrës pjesërisht një shoqëri e inkriminuar? A kemi aktualisht në Durrës, një pjesë të shoqërisë, në rastin më të pakët 20 mijë njerëz të rritur, të marrë peng, të kontrolluar apo të drejtuar nga krimi?

Vrasja, më 3 maj 2026, e dy fëmijëve, në trotuar – jo në rrugë – nga një shofer i dehur përsëritës, i terrorizoi shqiptarët gjer në palcë.

Ndërsa marshimi sensibilizues, organizuar nga qytetarët e Durrësit, ku morën pjesë diçka më tepër se 100 vetë, ishte zhgënjyës.

Ky ishte vlerësimi për drithërimat e dhimbjes dhe terrorit. Kaq ishte protesta për policinë e tredhur lokale, për mjediset e munguara për fëmijët...

Por, le të bëjmë një krahasim me drithërimat që provokon politika.

Fiks një vit më parë, më 11 maj 2025, qytetarët e Durrësit dolën masivisht

dhe bënë deputet, me rreth 20 mijë vota, një personazh të panjohur.

I futur në listat të hapura nga Partia Socialiste, për të u tha dhe po thuhet, se ishte investim dhe sponsoriim i bandave, apo Bandës së Durrësit.

Pra, logjika thotë, me zë të lartë, se, për thikën e futur gjer në palcë, nga padrejtësitë sociale, banorët e Durrësit nuk shfaqen. Ndërsa prej frikës, apo interesit nga krimi, prej frikës apo interesit nga pushteti politik, shfaqen të 200 – fishuar.

Të 200 – fishuar lënë mënjanë të gjitha impenjimet, veshin xhakëtën më të vlerësuar të garderobës, marrin edhe zonjat me vete dhe “marrsh” për të votuar.

Në këtë pikë ka një pyetje logjike që

kërçet: A është duke u formësuar në Durrës pjesërisht një shoqëri e inkriminuar?

A kemi aktualisht në Durrës, një pjesë të shoqërisë, në rastin më të pakët 20 mijë njerëz të rritur, të marrë peng, të kontrolluar apo të drejtuar nga krimi? Më tej, a mund të themi se e njëjta situatë është duke ndodhur edhe në Elbasan?

Në Elbasan, ku patëm një rezultat të njëjtë në zgjedhje, ku një e panjohur sërish mori rreth 20 mijë vota të dyshuara si të sponsorizuara nga krimi?

Apo në Fier, ku pas bëmave të Gramoz Ruçit, ndodhi revolucioni i paparashikuar i radhës?

Dihet botërisht se krimi i organizuar shqiptar u bashkua masivisht me politikën në prag të zgjedhjeve të vitit 2013, pas deklarimit “Aleancë me djallin, mjaft që të rrëzojmë Berishën!”

Dihet botërisht që politika, veçanërisht në Durrës, Elbasan dhe Fier, që janë tre qytetet me më shumë votues pas Tiranës, e ka ndarë pushtetin me krimin.

Dihet botërisht që në këto tre qytete, një emërim në poste të administratës publike, më shpejt e bën krimi, se politika.

Dihet botërisht që tenderat, qoftë nga buxheti i shtetit, qoftë rajonalë, që kanë lidhje me këto tre qytete, ndahen me krimin.

Dihet botërisht që në këto 3 qytete, gjithçka që ka lidhje me shtetin, kalon edhe së pari përmes filtrave të krimin, se strukturat vendore, policia, e të tjera, i nënshtrohen e shërbejnë, më tepër krimin, se partisë.

Ky është projekcioni djallëzor që duhet kuptuar para se të jetë shumë vonë.

Në Shqipërinë post 2013, një llogaritar me laps të hollë, pa e prekur Tiranën, ka projektuar dhe aplikuar, në 3 qytetet më të mëdha, veprën me geniale të gjithë karrierës së tij:

“Pushtet dhe para krimin të organizuar dhe përmes tij kontroll dhe shtypje, deri në kriminalizimin e shoqërisë, me qëllimin final – mbushjen e kutive të votimit”.

KRIMINALIZIMI I SHOQËRISË SI METODË PËR TË VJELË VOTA

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545

PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT



BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ



Shpresa Programme

Inspiring hope & change

VOLUNTEERS NEEDED!

WE NEED YOUR HELP!

Are you passionate about making a difference in people's lives? Do you want to help individuals facing challenges such as housing issues, welfare benefits, debt, immigration, and more?

We are looking for dedicated volunteers to join our Advice & Advocacy Team. This is a fantastic opportunity to gain hands-on experience, receive specialist training, and help increase our capacity to support vulnerable clients.

Contact us!

020 7511 1586
SHPRESAPROGRAMME@YAHOO.CO.UK
SHPRESAPROGRAMME.ORG

LUTFI DERVISHI

Çfarë ndodh kur inxhinieri, mjeku, piktori, deputeti dhe gazetari shkruajnë njëllonj?

Ndodh ajo që shohim rëndom sot: tekstet u ngjajnë deleve që i qeth i njëjti bari. Kanë të njëjtën prerje, të njëjtën lëkurë, të njëjtën vulë, por asnjë shenjë dalluese.

Bota është e bukur sepse njerëzit janë të ndryshëm. "Mendje mendje kjo dynja, mendja mendjes nuk i ngjan." Kur të gjitha tekstet fillojnë të tingëllojnë njësoj, humbet jo vetëm stili dhe larmia, por humbet gjëja më e rëndësishme në komunikim: besimi

Ky uniformitet maosit që sa vjen dhe bëhet më i bezdisshëm e ka një emër: përdorimi jo i mençur i AI.

"Kjo nuk është thjesht një marrëveshje, është një testament se çdo



hap ka një kosto..." apo metafora të sforcuara si "çmimet që trembin edhe retë", janë struktura tipike, të gjeneruara me një klik. Hiperbola të gatshme, kontraste artificiale dhe një "shije" sintetike që po mbush faqet tona. Të merr malli dhe ngazellehesh që

ende gjen postime të shkruara nga njeriu, ende dëgjon fjalime të prodhuara nga mendja, ende e kupton nga stili se cili është autori...

Ku janë fjalitë me nerv, gabimet njerëzore, batuta, ironia, ritmi, rrjedha që nuk mund të imitohen??

KUR DELET I QETH I NJËTI BARI

A duhet përdorur AI?

Absolutisht po. AI është asistent i përkryer kur je zot i zanatit tënd.

Por kur e lë atë të marrë timonin në dorë, del zbuluar. Binjaku digjital duhet të jetë varianti më i mirë i vetes, jo protezë për dembelizmin, mediokritetin apo padijes tonë. Në fakt ndoshta pyetja që duhet ngritur është: çfarë mbetet prej teje nëse të heq AI?

Për të patur trup të shëndetshëm kërkojmë ushqim bio, pse nuk bëjmë një gjë të tillë edhe për mendjen?

Sot po fryhen përrënjtë me përmbajtje të gjeneruar me AI, e ndoshta e ardhmja e gazetarisë do të jetë "lajmi bio", lajmi që mban aromë terreni, jo

zyre, lajmi që lind nga dyshimi, jo nga gullimi, lajmi që është i verifikuar nga njeriu. Prodhimi i mendjes së njeriut do të jetë "premium"

Sot gazetaria bio nuk është thjesht ndodhi kjo, ai tha, ajo u përgjigj... Kjo gazetari sot është rezistencë ndaj humbjes së identitetit është betejë kundër uniformitetit.

Nëse dështon kjo rezistencë gjithnjë e më pak njerëz do lexojnë, sepse do të velen duke lexuar një stil, duke ndjerë një ritëm, një intonacion artificial, një botë ku çdo fjali tingëllon sikur është shkruar nga e njëjta dorë, ose më keq, nga ASKUSHI.

Kudos për këdo që guxon/lodhet të nxjerrë në treg prodhime të mendjes, të shkruara me dorë njeriu.

TË ARDHURAT PËR FRYMË,
SHQIPËRIA PAS SERBISË DHE MALIT TË ZI

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për frymë në Ballkanin Perëndimor po hyn në një fazë të re rritjeje. Ky proces konvergjence me standardet e Bashkimit Europian po diktohet nga një sërë faktorësh strukturorë që Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) i ka konsideruar si kritikë për qëndrueshmërinë afatgjatë.

Sipas bazës së të dhënave të Fondit, Serbia dhe Mali i Zi kryesojnë listën me të ardhurat më të larta për frymë, përkatësisht me 17,252 dhe 16,377 dollarë sipas projeksioneve të këtij viti. Ky dominim shpjegohet me suksesin e Serbisë në thithjen e industrive prodhuese dhe modernizimin e infrastrukturës, ndërsa Mali i Zi përfiton nga pozicionimi si një qendër elitare e turizmit mesdhetar.

Shqipëria, sipas projeksioneve, pozicionohet e treta në rajon me 12,493 USD për frymë, duke tejkaluar Maqedoninë e Veriut (11,967 USD) dhe Bosnjë-Hercegovinën (10,701 USD). Ecuria e Shqipërisë lidhet me disiplinën fiskale dhe zhvillimet pozitive në sektorin e turizmit. Kosova parashikohet të arrijë në 8,958 USD të ardhura për frymë këtë vit duke u renditur e fundit në Rajon. Për Kosovën FMN vë re një potencial të lartë rritjeje nëse vazhdohet me përmirësimin e ambientit të biznesit dhe investimet në kapitalin njerëzor, veçanërisht në sektorin e teknologjisë.

Perspektiva 2031 në përmirësim për të gjitha vendet

Në horizontin pesëvjeçar 2026–2031, FMN parashikon një përsheptim të rritjes për të gjitha ekonomitë e rajonit. Serbia pritet të arrijë shifrën 25,291 USD për frymë në vitin 2031, duke u shndërruar në liderin e padiskutueshëm ekonomik të rajonit.

Kjo rritje pritet të mbështetet nga in-



tegrimi më i thellë në zinxhirët e furnizimit të BE-së. Mali i Zi pritet të ndjekë me 21,214 USD për frymë, ku stabiliteti makroekonomik do të jetë kyç për të ruajtur flukset e investimeve.

Për Shqipërinë, FMN parashikon një nivel të ardhurash për frymë prej 17,353 USD në vitin 2031. Kjo rritje mbështetet nga vazhdimësia së reformave institucionale ndikimin pozitive të reformave dhe fondeve të para-anëtarësimit në BE. Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina parashikohen të arrijnë respektivisht 16,354 USD dhe 14,084 USD, ndonëse FMN paralajmëron se rreziqet gjeopolitike

dhe çmimet e energjisë mund të diktojnë luhajtje.

Kosova pritet të arrijë në 12,483 USD, duke shënuar rritjen më të madhe në përqindje, çka dëshmon një proces të shpejtë "catching-up" me fqinjët.

Viti 2026 shënon një pikë kthesë ku diferencat mes vendeve të rajonit bëhen më të prekshme.

Retrospektiva 2010–2026, si u rriten te ardhurat në Rajon

Duke analizuar periudhën 2010–2026, të dhënat historike të FMN-së

tregojnë një rrugëtim shpesh të vështirë. Në vitin 2010, rajoni ishte ende nën efektet e krizës financiare globale, me Shqipërinë që regjistronte vetëm 4,098 USD për frymë. Gjatë kësaj periudhe 16-vjeçare, Shqipëria ka arritur të dyfishojë të ardhurat e saj, kryesisht nga forcimi i monedhës vendase dhe prurjet nga jashtë dhe rritjes në sektorin e turizmit.

Rritja më e qëndrueshme është vërejtur te Serbia dhe Mali i Zi, të cilët kanë pasur baza fillestare më të forta. Megjithatë, viti 2020 shënoi një pikë kritike për shkak të pandemisë, ku FMN nënvizoi se vetëm vendet me rezerva fiskale të forta arritën të

rimëkëmbeshin shpejt. Rimëkëmbja pas-pandemike ka qenë më e fortë se pritshmëritë fillestare, duke i lejuar rajonit të hyjë në vitin 2026 me një bazë më të sigurt. Ky maturim ekonomik, i monitoruar nga afër prej Fondit Monetar Ndërkombëtar, sugjeron se Ballkani Perëndimor po lë pas epokën e tranzicionit për të hyrë në një fazë të konsolidimit të mirëqenies.

Nga viti 2010 deri në projeksionet e detajuara për vitin 2031, rajoni tregon një trajektore rritëse, ku çdo vend ka mobilizuar burime specifike. Shqipëria, sipas analizave të FMN-së, ka treguar një rezistencë të lartë falë performancës së sektorit të turizmit dhe rritjes së investimeve në ndërtim, të cilat kanë shërbyer si motorë kryesorë.

Në Serbi, FMN vëren se politikat e mbrojtjes së investimeve të huaja direkte dhe zgjerimi i bazës industriale kanë krijuar një distancë domethënëse me fqinjët. Mali i Zi, nga ana tjetër, mbetet i varur nga shërbimet, por po diversifikon portofolin përmes energjisë së rinovueshme.

Për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, FMN thekson rëndësinë e reformave në tregun e punës dhe rritjen e produktivitetit për të përballuar sfidat demografike. Këto trajektore tregojnë se rajoni po kalon nga një fazë e rritjes së bazuar në konsum, drejt një rritjeje më të qëndrueshme të bazuar te eksportet dhe investimet, çka reflektohet në shifrat optimiste të dekadës së ardhshme./ Monitor

ARDI STEFA

Dje, një djalosh i ri, rreth 19-20 vjeç, kishte publikuar në Facebook një shkrim për politikën, të majtën dhe të djathtë. I shkruajta poshtë shkrimit “Rroftë ChatGPT!”. M’u përgjigj të shkoja të shikoja profilin e një politikaneje të lartë të “kampit kundërshtar”, se shkrimi ishte i tij dhe më sugjeronte të lexoja librin dhe autorin, të cilin e kishte cituar.

Replika ime ishte që të përmbahej e të mos gënjente, pasi për shkak të profesionit gjuhën shqipe e njoh, mendoj, shumë mirë. Përgjigje nga personi në fjalë nuk pati, por komentet e tjera ishin ditirambe për të...

Dhe ndërkohë filloj reflektimin tim. Dikur duhej të lexoje libra për t’u dukur i zgjuar. Sot mjafton një lidhje në internet, një situatë “më shkruaj një analizë filozofike mbi demokracinë moderne” dhe një “copy paste”. Brenda pesë sekondash lind një tjetër “analist”, “gazetar”, “filozof”, “politolog”, “ekspert gjeopolitike” apo “mendimtar publik” me status Facebook-u dhe ego akademiku.

Madje edhe mund të kërkosh që artikullin ta bëjë “më therës”, më të mprehtë, me citime filozofesh, shkrimtarësh apo politikanësh, që as ua ke dëgjuar emrin, jo më t’i kesh

TË DUKESH I DITUR E JO TË JESH I DITUR ËSHTË KTHYER NË MODË



lexuar apo studiuar.

Prej OpenAI dhe ChatGPT, Shqipëria ka hyrë në epokën më të çuditshme: në epokën e popullit gazetar e analist shqiptar, në epokën më të çuditshme të dijes, në epokën ku njerëzit citojnë libra që s’i kanë hapur kurrë, përmendin filozofë emrin e të cilëve mezi e shqiptojnë dhe bëjnë analiza politike mbi koncepte që nuk i kuptojnë as në nivelin e një fjalori.

Sot shoh ndonjë status me emra si Friedrich Nietzsche, Fyodor Dostoyevsky apo Niccolò Machiavelli dhe kupton menjëherë që autori nuk ka lexuar as parathënien e librave të tyre. Por nuk ka problem. ChatGPT ua nxjerr citimin, ua ndërton analizën dhe ua jep edhe tonin “intelektual”. Ata pastaj e hedhin në Facebook si pulën që ka pjellë vezën e shekullit. Dhe nuk është problemi te përdorimi i inteligjencës artificiale. Personalisht jam pro përdorimit të IA, sepse mund të jetë një asistent i përkryer i profe-

sionit, fjalës dhe mendimit tonë. Por kur s’je as i zoti, s’ke as mendim e fjalë IA të nxjerr zbuluar. Tregon se se dembel e sa pak je kur heq Inteligjencën Artificiale.

Përdorimi i IA nuk është problemi. Problemi është te marrëzia natyrale. Sepse një mjet mund të të ndihmojë të shkruash më mirë, por nuk të jep mendim kritik. Nuk të mëson gramatikën e shqipes. Nuk të mëson morfologjinë, sintaksën, ritmin e fjalisë, peshën e fjalës, harmoninë e mendimit. Nuk të mëson dallimin

mes një argumenti dhe llogjeve të kafeneve.

Sot lexojmë “artikuj” ku fjalja fillon në Vlorë dhe mbaron në Kuala Lumpur. Artikuj ku logjika gjuhësore e shqipes përdhoret. Presja është zhdukur, është zëvendësuar me vizën në mes, ndërsa kur vihet, vihet në mënyrë të gabuar përpara lidhëzës bashkërenditëse “dhe”. Foljet rrihen me kohët dhe mënyrat si deputetët në Kuvendin e Shqipërisë. Mbiemrat përdoren keq aq sa cilësimet ngatërohen me marrëdhëniet. Artikuj ku fjalët përkthehen mekanikisht, aq sa shqipja duket si ndonjë gjuhë ilegale që ka hyrë kontrabandë nga Google Translate.

Dhe më tragjikja është entuziazmi infantil i disa çunakëve që mezi shkruajnë një kërkesë pa gabime, por pretendojnë autorësinë e “eseve”, “analizave” dhe “platformave e shkrimeve politike e filozofike” të prodhuara nga ChatGPT apo OpenAI. I shohin me vetëbesimin e një akademiku, ndërkohë që nuk dinë as renditjen bazë të fjalëve në fjalë. Nuk

kanë idenë e koherencës apo kohezionit gjuhësor. Nuk njohin as nyjen, as rasën, as kuptimin e një metafore, por flasin për “dekonstruktimin epistemologjik të narrativës politike”.

Dhe lexuesi vret mendjen të zbrërthetë fjalitë kilometrike, si fjalitë e Don Kishotit të Mançës: “Arsyeja e mosarsyes që i bëhet arsyes sime, ma dobëson aq shumë arsyen sa me arsye vajtoj bukurinë tënde!”

Faktëqësisht të dukesh i ditur e jo të jesh i ditur është kthyer në modë.

Dija kërkon kohë. Kërkon libra. Kërkon mundim. Kërkon net pa gjumë, gabime, redaktime, korrigjime. Ndërsa sot kërkohet vetëm një prompt i shkruar keq dhe një ego e shkruar edhe më keq.

Fatqëqësisht, Inteligenca Artificiale nuk po nxjerr në pah inteligjencën njerëzore. Në shumë raste po nxjerr në pah vanitetin dhe paditurinë njerëzore në përdorimin e teknologjisë jo për të mësuar më shumë, por për t’u dukur më shumë.

Bota po hyn sërish në të njëjtën kurth që ka sjellë përplasje, proteksionizëm dhe kriza të mëdha financiare. Nga njëra anë janë vendet që kursejnë dhe eksportojnë shumë, si Kina, Gjermania apo Japonia, nga ana tjetër është SHBA, që vazhdon të blejë, të marrë borxh dhe të mbajë mbi shpinë çekuilibrimet e sistemit. Financial Times në një analizë sot, të cilën Lapsi.al e ka lexuar dhe po e përshtat në shqip, shkruan se kjo është skemë është e njohur dhe alarmante. Kur pabarazitë globale arrijnë këtë pikë, zakonisht nuk mbarojnë me qetësi. Fillimisht vjen zemërimi politik dhe populistët. Pastaj vjen kriza, pasojat e së cilës i ndjen çdo qytetar i globit. Dhe kësaj here, shpërthimi mund të nisë nga vetë Amerika.

“A nuk e kemi bërë edhe një herë këtë debat?” Kështu nis një nga esetë e një botimi të fundit të Centre for Economic Policy Research mbi “Pabarazitë e reja globale”. Dhe përgjigjja është po. Ky debat është bërë në vitet ’80, u rikthye në vitet 2000 dhe tani po rikthehet sërish në vitet 2020.

Rreth çdo 20 vjet, bota duket se përballlet me të njëjtin problem. Disa vende kursejnë dhe eksportojnë shumë më tepër se sa konsumojnë, ndërsa disa të tjera, kryesisht SHBA, marrin hua dhe blejnë më shumë nga sa prodhojnë. Këto pabarazi nuk janë thjesht çështje tabelash ekonomike. Ato prodhojnë dy pasoja të rrezikshme, rritje të proteksionizmit dhe, herët a vonë, kriza financiare.

Kjo ka ndodhur më parë. Në vitet ’80, zemërimi ekonomik u drejtua ndaj Japonisë dhe pikërisht aty shpërtheu edhe një krizë e madhe. Në vitet 2000, me të ashtuqajturin “shoku i Kinës”, zemërimi u kthye ndaj Pekinit, ndërsa

FINANCIAL TIMES NGRE ALARMIN: BOTA PO SHKON SËRISH DREJT NJË KRIZË TË MADHE EKONOMIKE

kriza financiare goditi Perëndimin. Në vitet 2020, proteksionizmi është tashmë këtu, sidomos në SHBA. Kriza e madhe financiare ende nuk ka ardhur. Të paktën jo akoma.

Pse po rikthehet ky rrezik?

Sot, si edhe dy dekada më parë, vendet me suficit të madh (vendet që shesin më shumë jashtë se sa importojnë) janë pothuajse të njëjtat, Kina, Gjermania dhe vende të tjera europiane, Japonia dhe eksportuesit e naftës. Ndërkohë, SHBA mbetet huamarrësi kryesor i botës.

Por ka edhe një ndryshim të rëndësishëm nga viti 2008. Atëherë, deficitin amerikan lidhej më shumë me borxhin e sektorit privat, me konsumatorët dhe sistemin financiar. Sot, pesha më e madhe bie mbi shtetin amerikan. Me fjalë të thjeshta, sot është qeveria amerikane ajo që po mban mbi shpinë pjesën më të madhe të këtij çekuilibri. Dhe kjo i shqetëson ekonomistët. Sipas tyre, nëse vjen një krizë e re, ka shumë mundësi që ajo të nisë pikërisht nga SHBA. Arsyeja është se borxhi i jashtëm amerikan është shumë më i lartë se dikur, tregjet financiare janë të mbingarkuara, vlerësimet e aseteve janë të fryra dhe nervozizmi i investitorëve po rritet. Kina, SHBA dhe logjika e pabarazisë Një nga idetë kryesore të kësaj analize është se tregtia, financat dhe proteksionizmi janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Financial Times merr si shembull

Kinën. Ajo ka një nivel shumë të ulët të konsumit familjar krahasuar me madhësinë e ekonomisë së saj. Kjo do të thotë se kursen shumë. Kur një vend kursen kaq shumë, ato kursime duhet të shkojnë diku. Nëse nuk përthithen dot brenda ekonomisë vendase, atëherë eksportohen jashtë. Dhe mënyra më e drejtpërdrejtë për ta bërë këtë është duke pasur suficit tregtar (të eksportosh më shumë se sa importon).

Në rastin e Kinës, kjo do të thotë prodhim masiv industrial dhe eksport i madh mallrash. Pra, suficitit tregtar gjigant i Kinës nuk vjen vetëm sepse ajo është “më konkurruese”, por edhe sepse ka një çekuilibër të madh të brendshëm ekonomik. Në anën tjetër, nëse Kina kursen shumë, dikush tjetër duhet të shpenzojë shumë. Dhe ai “dikush tjetër” është zakonisht SHBA.

Me pak fjalë, suficitit i njërit është deficitit i tjetrit. Ose nëse një vend del me tepriç (fitim) nga tregtia, një vend tjetër del me mungesë (humbje). Pse kjo është problem?

Sepse kjo lojë nuk mund të zgjasë pa fund.

Ekziston një ligj i thjeshtë në ekonomi. Nëse diçka nuk mund të vazhdojë përgjithmonë, në një moment do të ndalet. Problemi është si do të ndalet. Në mënyrë të kontrolluar apo me krizë?

Rreziku i parë është proteksionizmi. Një pjesë e asaj që po shohim sot në

politikën amerikane, sidomos te Donald Trump, është reagim ndaj goditjes së dikurshme nga Kina. Tarifat, gjuha agresive dhe sulmet ndaj importeve janë pjesë e këtij refleksi. Në Europë, shqetësimi po rritet gjithashtu, sepse tani nuk është vetëm industria amerikane që ndjen presionin e Kinës, por edhe ajo europiane.

Rreziku i dytë është kriza financiare. Nëse SHBA vazhdon të marrë borxh pafund dhe vendet me suficit vazhdojnë të mbështeten te huamarrja e të tjerëve për të mbajtur ekonominë e tyre në këmbë, sistemi në një moment mund të këputet.

Tre iluzione që duhen hedhur poshtë Financial Times argumenton se për të shmangur një krizë, politikanët duhet të heqin dorë nga disa ide të gabuara. Iluzioni i parë është se deficitit tregtar amerikan mund të zgjidhet vetëm me tarifa ose me kurs këmbimi. Nuk mjafton kjo. SHBA duhet të rregullojë edhe problemet e veta të brendshme, sidomos deficitin shumë të lartë buxhetor.

Iluzioni i dytë është i kundërt: se fajin e ka gjithmonë huamarrësi. Pra, se mjafton që SHBA të shtrëngojë shpenzimet dhe gjithçka rregullohet. Kjo mund të ketë sens për vende të vogla. Por jo për ekonominë më të madhe të botës. Nëse Amerika ul fort shpenzimet, ndërsa Kina dhe Europa nuk rrisin kërkesën e tyre të brendshme, atëherë bota futet në ngadalësim ekonomik.

Iluzioni i tretë është mendësia merkantiliste, ideja se një vend bëhet i pasur duke mbajtur gjithmonë suficit. Kjo ka dy rreziqe: një ditë debitorët nuk paguajnë më, dhe për më tepër fillojnë të urrejnë vendet me suficit sepse i shohin si shkatërrues të industrisë së tyre. Pikërisht kjo ndjenjë po rritet sot ndaj Kinës, dhe në një masë më të vogël edhe brenda Europës.

Çfarë duhet bërë?

Në teori, zgjidhja është e qartë. SHBA duhet të ulë deficitin publik. Kina duhet të rrisë konsumin e brendshëm. Europa duhet të mbështetet më shumë te kërkesa e vet dhe më pak te eksportet. Pra, ekonomitë e mëdha duhet të balancohen nga brenda, në vend që t’ia hedhin peshën njëra-tjetrës.

Po ashtu, duhen korrigjime në politikën tregtare dhe industriale, në mënyrë që bota të mos shkojë drejt një lufte të re ekonomike.

Por problemi, sipas FT, është se shanset që kjo të ndodhë me zgjuarsiri dhe në kohë janë pothuajse zero. Epoka e populizmit, nacionalizmit dhe vendimeve të pamenduarra e bën shumë të vështirë veprimin racional dhe të koordinuar.

Prandaj përfundimi i analizës është i zymtë, por i qartë: nëse bota nuk është më në gjendje të parandalojë krizën, atëherë të paktën duhet të përgatitet për të.

Koha për ta bërë këtë është tani.

Dotech

websites 

UPGRADE YOUR WEBSITE

100%
Trusted

I jepni biznesit tuaj një faqe moderne, të shpejtë dhe të lehtë për t'u përdorur, e cila i shndërron vizitorët në klientë. Ne e ridizenjojmë, optimizojmë dhe përmirësojmë faqen tuaj për të rritur performancën, dukshmërinë dhe ndikimin.

Our Services

- ✓ Custom web design
- ✓ E-commerce setup
- ✓ Mobile optimization
- ✓ Website maintenance
- ✓ SEO structure

Build a website that works beautifully fast and converts visitors into customers.

NA KONTAKTONI

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



EMIN AZEMI

Arkitektura tekstore e librit “Nëpër gjethe kujtimesh” e ndërtuar nga tri “shtylla” fabulare “Fëmijëria”, “Tregime të mëvonshme” dhe “Tregime nga Londra”, dëshmon se krijimtaria e Daut Dautit përbën një mozaik të gjallë të kujtesës individuale e kolektive, ku ndërthuren autobiografia, mitologjia popullore, kronika shoqërore dhe reflektimi kritik. Nga bota e thjeshtë e fshatit dhe kujtesa e fëmijërisë, te transformimet kulturore e shoqërore të dekadave të fundit dhe deri te përvoja urbane e mërgimit në metropolin londinez, autori arrin të ndërtojë një narrativë që e kthen përditshmërinë në dëshmi letrare dhe kulturologjike. Nëpërmjet humorit, ironisë dhe vëzhgimit të hollë të jetës, këto rrëfime shndërrohen në një kronikë të ndjeshme të kohës dhe të identitetit, duke ruajtur gjallërinë e tradicionales dhe duke i dhënë asaj një dimension modern letrar.

Letërsia autobiografike që mbështetet në kujtesën personale shpesh shndërrohet në një palimpsest artistik ku ndërthuren përjetimi individual dhe memoria kolektive. Libri “Nëpër gjethe kujtimesh” i Daut Dautit përfaqëson pikërisht një formë të tillë shkrimi, ndërkohë që rrëfimi personal shndërrohet në një panoramë të jetës shoqërore, mitologjike dhe historike të Kosovës në gjysmën e dytë të shekullit XX. Përmes një narrative të ndërtuar mbi perspektivën e fëmijërisë, të rinisë dhe të përvojës intelektuale në mërgim, autori krijon një univers letrar ku bashkëjetojnë realiteti, kujtesa dhe simbolika kulturore.

Struktura e veprës është e ndarë në tri pjesë: Fëmijëria, Tregimet e mëvonshme dhe Tregimet nga Londra. Ky organizim nuk është thjesht kronologjik, por përfaqëson një zhvillim të teknikës narrative. Në pjesën e parë dominon vështrimi i fëmijës, i cili përmes një gjuhe të thjeshtë dhe plot gjallëri përshkruan jetën e fshatit, ritualet, bestytinitë, frikërat dhe gëzimet e hershme. Në pjesët pasuese rrëfimtari shndërrohet në një vëzhgues më të pjekur, i cili e sheh realitetin me një sy kritik dhe reflektues, sidomos kur përballet me botën perëndimore dhe përvojën e mërgimit.

Një nga elementet më të rëndësishme të librit është dimension i mitologjisë popullore. Në shumë tregime paraqiten zakone, rituale dhe besime që janë pjesë e traditës së fshatit shqiptar. Episodi i larjes së foshnjës në ujë me gjethe shelgu dhe hitre në prag të Shëngjergjit është një shembull i qartë i kësaj trashëgimie simbolike. Kjo skenë nuk është vetëm një kujtim personal, por një pasqyrë e botëkuptimit tradicional, ku natyra dhe ritet shihen si pjesë e harmonisë së jetës njerëzore. Po kështu, vendet si “Pusi i Kallakangjës”, “Kroi i Ftohtë” apo “Vorret e Plakave”, përpos si topos letrare, marrin dimension mitik dhe shndërrohen në



hapësira fantazmagorike ku ndërthuren realiteti dhe imagjinata kolektive.

Shkrimtari Daut Dauti, me përvojën e hulumtuesit dhe të publicistit, librin e tij e ndërton sipas teknikës së narracionit imazherik dhe skaltjes së personazheve karakteristike. Ai krijon një galeri figurash që përfaqësojnë tipare të ndryshme të jetës rurale: mullinxhiu që frikësohet nga lepurit, gjuetari Taha që duket si një figurë e epokës parahistorike, aga Nezë që ndërton shkollën me përkushtim të jashtëzakonshëm, Dada Pestile, Timja e trent etj. Këto figura nuk janë vetëm individë konkretë, por edhe arketipe sociale, të cilët simbolizojnë mentalitete dhe mënyra jetese të një epoke të caktuar.

Librin e Daut Dautit duhet lexuar edhe si kronikë e një kohe që s’kthehet më, por që në kujtesën tonë prodhon ndjesinë e preksshmërisë së gjërave. Kjo arrihet në saje të një rrëfimi që ndërtohet mbi kontraste të forta: fshati dhe qyteti, tradita dhe moderniteti, izolimi dhe hapja ndaj botës. Përmes këtyre kontrasteve autori arrin të nxjerrë në pah edhe realitetin politik dhe social të kohës së socializmit në ish-Jugosllavi. Në sfond të tregimeve shfaqet një realitet i pabarazisë dhe i tensioneve historike, ku shqiptarët përjetojnë një marginalizim politik, ekonomik dhe kulturor. Ky dimension historik shfaqet jo në formë të drejtpërdrejtë, por përmes kujtimeve, tregimeve të pleqve dhe episodeve të jetës së përditshme.

EMIN AZEMI: LETËRSIA E KUJTIMEVE DHE NARRATIVA E PËRVOJAVE

Stilistikisht, proza e Daut Dautit karakterizohet nga një gjuhë e qartë, e pasur me figuracion dhe me elemente të humorit të hollë. Humori shpesh shfaqet në përshkrimet e situatave të thjeshta të jetës së fshatit, duke krijuar një ekuilibër mes nostalgjisë dhe ironisë. Përmes këtij stili autori arrin të krijojë një atmosferë të gjallë narrative, ku lexuesi jo vetëm e ndjek rrëfimin, por edhe e përjeton emocionalisht atë.

Letërsia e kujtesës dhe e përvojës personale shpesh krijon një hapësirë të veçantë ku ndërthuren përjetimet personale, historia sociale dhe refleksioni kritik mbi realitetin. Rrëfimet e përmbledhura në ciklin “Tregime të mëvonshme” përfaqësojnë një shembull domethënës të kësaj ndërthurje, duke shpalosur përmes episodit autobiografik një panoramë të botës shqiptare në periudha të ndryshme historike dhe kulturore. Në këto rrëfime, autori ndërton një diskurs narrativ që lëviz mes kujtesës së fëmijërisë, përvojës së mërgimit, ironisë sociale dhe refleksionit kulturor. Në këtë mënyrë, teksti merr një karakter të dyfishtë: here si dokument i përvojës personale dhe here si një formë e kritikës së nënkuptuar ndaj realiteteve historike e shoqërore.

Duke eksploruar botën shpirtërore e morale të njerëzve, autori na sjell një shembull të qartë të mënyrës se si mendësia tradicionale transmetohet përmes figurës së gjyshes (Lokës), e cila vazhdimisht mendon se: “Kjo botë shpejt do të bëhet hashërr-

neshërr”. Bota e saj konceptohet në një dualitet të prerë: “Na” dhe “Ata”. Ky model binar i perceptimit të botës është tipik për kulturat tradicionale ku identiteti ndërtohet përmes dallimit dhe ruajtjes së kufijve simbolikë. Shprehja metaforike “hashërr-neshërr”, që nënkupton përzierjen dhe humbjen e dallimeve, përfaqëson një frikë të trashëguar kolektive për zhdukjen e identitetit kulturor. Në këtë kontekst, fjala popullore e Lokës funksionon si një proverb folklorik që sintetizon një filozofi të tërë jetësore.

Nga ana tjetër, rrëfimet që lidhen me mërgimin dhe përvojën në Zvicër paraqesin një dimension tjetër të diskursit narrativ: përplasjen mes botës tradicionale dhe modernitetit global. Përshkrimet e protestave në Cyrih apo të jetës së emigrantëve krijojnë një kontrast të fortë mes imazhit të Zvicrës si “parajsë” dhe realiteteve sociale që autori has në të. Në këtë kontekst, episodet humoristike apo groteske, si ai i shqiptarit që pëson “plagë dashurie”, marrin funksionin e një satire sociale. Humori këtu nuk është vetëm element narrativ; ai është edhe mekanizëm kritik që zbut dhe njëkohësisht demaskon paradokset e jetës së emigrantit.

Një tjetër tipar i rëndësishëm i këtyre tregimeve është përdorimi i ironisë dhe groteskut si mjete retorike. Episodet që përshkruajnë situata të çuditshme apo komike qoftë në marrëdhëniet mes njerëzve, qoftë në përshkrimin e zakoneve dhe sjelljeve krijojnë një efekt të dyfishtë: nga njëra anë argëtojnë lexuesin, ndërsa

nga ana tjetër e shtyjnë atë të reflektojë mbi absurditetin e disa realiteteve shoqërore. Kjo teknikë narrative është e njohur në traditën e rrëfimit ballkanik, ku anekdota dhe satira shpesh shërbejnë si forma të kritikës indirekte.

Në planin simbolik, disa nga episodet më të thjeshta marrin një dimension alegorik. Për shembull, tregimi për dy gomarët në oborrin e spitalit në Tivar mund të lexohet si një metaforë e heshtur për realitetin institucional dhe për paradoksin e jetës në një hapësirë ku mungojnë shërbimet elementare për njerëzit. Në këtë kuptim, figura e gomarit e njohur në folklorin shqiptar si simbol i durimit dhe i përlësisë transformohet në një figurë satirike që vë në pah kontrastin mes natyrës dhe organizimit shoqëror.

Rrëfimet e këtij libri karakterizohen nga një stil i drejtpërdrejtë, narrativ dhe shpesh bisedor. Ky stil krijon një afërsi të veçantë me lexuesin dhe i jep tekstit një autenticitet të dukshëm. Përdorimi i dialogut, i shprehjeve popullore dhe i situatave të përditshme e afron tekstin me traditën e rrëfimit gojor. Në këtë mënyrë, autori e ndërton narrativën si një vazhdim të kulturës së tregimit tradicional shqiptar, ku kujtimi personal bëhet pjesë e kujtesës kolektive.

Londra, si një nga metropolet më të mëdha dhe më shumëkulturore të botës, ka qenë gjithmonë një hapësirë ku historitë personale ndërthuren me historinë e madhe. Në këtë kontekst, tregimet që lindin nga përvoja e jetës në këtë qytet marrin shpesh formën e një kronike të vogël njerëzore, ku përditshmëria, kujtesa dhe imagjinata krijojnë një lloj folklori urban modern. Kapitulli “Tregime nga Londra” përfaqëson pikërisht një ndërthurje të tillë: një mozaik rrëfimesh që bashkojnë figura historike, përvoja personale dhe legjenda urbane, duke krijuar një narrativë që mund të lexohet njëkohësisht si dokument kulturor dhe si material për analizë letrare e retorike.

Në fillim të këtij rrëfimi shfaqet figura e Faik Konicës, e cila vendos një bosht historik dhe kulturor për gjithë tekstin. Londra nuk paraqitet vetëm si qytet, por si një hapësirë ku identiteti shqiptar merr dimension ndërkombëtar. Konica paraqitet si një intelektual kompleks një figurë që përmbledh elegancën aristokratike, mendimin kritik dhe lidhjen me qendrat kryesore të kulturës evropiane.

Miqësia e tij me poetin francez Guillaume Apollinaire krijon një dimension të ri kulturor. Kjo marrëdhënie simbolizon takimin e dy traditave intelektuale dhe tregon se kultura shqiptare nuk ka qenë e izoluar, por pjesë e dialogut evropian të fil-


limshekullit XX. Poezitë e Apollinaire-it, të shkruara gjatë vizitave në shtëpinë e Konicës, e shndërrojnë hapësirën londineze në një vend krijimi artistik dhe në një pikë takimi të kulturave.

Në këtë kontekst, Annie Playden shfaqet si një figurë poetike dhe simbolike një muzë e paditur për ndikimin që kishte në imagjinatën e një gjeniu letrar. Ky episod përforcon idenë se jeta e përditshme shpesh bëhet burim i artit të madh, duke e lidhur përvojën intime me krijimin universal.

Në pjesët e tjera të tregimeve, autori kalon nga figura historike në përvoja të zakonshme të jetës në Londër. Këto episode si historia e çiftit irlandez-iranian apo rrëfimi për tifozët shqiptarë në Kardif krijojnë një tablo të gjallë të diasporës dhe të ndërveprimit kulturor.

Tregimet e Daut Dautit funksionojnë si rrëfime moderne që bartin elemente të humorit, ironisë dhe reflektimit social. Për shembull, dialogu mes Brianit dhe Nurës përshkruan me një episod të thjeshtë tensionet dhe ndjeshmëritë në marrëdhëniet njerëzore. Ky lloj rrëfimi përmban strukturën klasike të fabulës tregimtare: një situatë e zakonshme, një moment kulmor dhe një reflektim i heshtur që mbetet tek dëgjuesi ose lexuesi.

Gjithashtu, përshkrimi i tifozëve shqiptarë në stadiumin e Kardifit krijon një skenë kolektive ku identiteti kombëtar shprehet përmes ritualit sportiv. Në këtë rast, stadiumi bëhet një skenë simbolike ku diaspora afir-



mon praninë dhe solidaritetin e saj.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i këtyre tregimeve është reflektimi mbi ndryshimet sociale dhe teknologjike. Rrëfimi për kabinat e kuqe të telefonit dhe për evoluimin e komunikimit përfaqëson një formë nostalgjie kulturore. Autori përshkruan një botë që po zhduket botën e pritjes në radhë për një telefonatë dhe të komunikimit të rrallë, por të çmuar. Për rrjedhojë, teksti mund të lexohet edhe si një kritikë e heshtur ndaj individualizmit modern.

Përshkrimi i marrëdhënieve të ftohta mes fqinjëve në Londër thekson kontrastin mes kulturës urbane perëndimore dhe traditës ballkanike të "kojshillëkut". Ky kontrast shërben si një reflektim sociologjik mbi ndryshimin e mënyrave të jetesës dhe të marrëdhënieve njerëzore.

Një nga elementet më interesante në teknikën narrative të tekstit është rrëfimi për "Njeriun Pëllumb". Ky episod përmban të gjitha elementet e një legjende urbane: një personazh misterioz, një histori të paqartë dhe një rrjet tregimesh që qarkullojnë në

komunitet. Në kontekstin e sociologjisë urbane, figura të tilla shërbejnë si simbole të marginalitetit dhe të misterit të qytetit. Londra, në këtë rast, shfaqet si një hapësirë ku realiteti dhe imagjinata ndërthuren, duke krijuar mite të reja që zëvendësojnë legjendat tradicionale.

Në disa pjesë të tregimeve, rrëfimi kalon nga përvoja personale në histori më të gjera historike. Rasti i bombardimit të Mançesterit nga IRA dhe historia e ndihmës së Sulltan Abdyl Mexhidit gjatë urisë së patateve në Irlandë përfaqësojnë momente ku his-

toria globale ndërhyjnë në rrëfimin personal.

Këto episode e pasurojnë tekstin me dimension historik dhe tregojnë se tregimet e vogla të jetës shpesh zhvillohen në sfondin e proceseve të mëdha historike.

Arkitektura tekstore e librit "Nëpër gjethe kujtimesh" e ndërtohet nga tri "shtylla" fabulare "Fëmijëria", "Tregime të mëvonshme" dhe "Tregime nga Londra", dëshmon se krijimtaria e Daut Dautit përbën një mozaik të gjallë të kujtesës individuale e kolektive, ku ndërthuren autobiografia, mitologjia popullore, kronika shoqërore dhe reflektimi kritik. Nga bota e thjeshtë e fshatit dhe kujtesa e fëmijërisë, te transformimet kulturore e shoqërore të dekadave të fundit dhe deri te përvoja urbane e mërgimit në metropolin londinez, autori arrin të ndërtojë një narrativë që e kthen përditshmërinë në dëshmi letrar dhe kulturologjike. Nëpërmjet humorit, ironisë dhe vëzhgimit të hollë të jetës, këto rrëfime shndërrohen në një kronikë të ndjeshme të kohës dhe të identitetit, duke ruajtur gjallërinë e tradicionales dhe duke i dhënë asaj një dimension modern letrar. Për rrjedhojë, librin e Dautit nuk duhet kuptuar vetëm një përmbledhje tregimesh, por një thirrje për të ruajtur kujtesën kolektive dhe për të kuptuar rrugëtimin e njeriut shqiptar ndërmjet vendlindjes dhe botës, duke dëshmuar se letërsia mbetet një nga format më të fuqishme për ta mbajtur të gjallë historinë, kulturën dhe përvojën njerëzore.

AURON TARE

Para pak ditësh pata shkruar disa radhë për Pazarin e Gjirokastrës atë vend ku dikur rrihte pulsi i qytetit, por sot, vetëm fasada ruan pjesën historike, ndërsa dyqanet e vogla duken si Dugaja me mallra nga Lindja e Largët.

Si zakonisht, unë shkruaj për kënaqësinë time dhe të atyre që lexojnë. Mirëpo, shënimi im paska pasur edhe lexues të vëmendshëm nga administrata dhe një njeri që e çmoj dhe që, për këtë arsye, meriton një përgjigje me shkruante "Auron, pse e sheh gotën bosh? Ne kemi artizanë në Pazar."

Dhe, për të më bindur, më dërgonte edhe fotografinë e një zonje të përkulur mbi avlëmend një figurë që, në çdo pazar normal, do të ishte simbol i një tradite të mbajtur gjallë e jo përjashtim i rrallë.

Unë, nga ana ime, nuk kam asnjë arsye të mohoj ekzistencën e këtyre njerëzve. Përkundrazi, Gjirokastra, si qyteti i të parëve të mi, zë një vend të veçantë tek unë, por pikërisht për këtë më dhemb kur kontrasti me atë që duhet të ishte e zakonshme sot është bërë përjashtim.

GOTA



një qëndistare, një gurëgdhendës, një dru-gdhendës e gjysmë (gjysma nuk është e regjistruar ende), 3 zonja që merren me kostume dhe një zonjë tjetër me qilima.

Është edhe një vajzë e re, e cila mundohet të prodhojë sapun shtëpie, si dhe një zonjë mjaft e këndshme, e cila u bën vizitorëve kafën tradicionale të Gjirokastrës, të bluar në gur dhe të zier në rërë të nxehtë. Të tjerat?

Kafene me karrige në rrugë, suvenire turke dhe kineze, si dhe një univers i pafund sendesh që nuk kanë lidhje me Shqipërinë, por mbajnë me "krenari" emrin e saj. Mallrave që vijnë nga Kina e Turqia u është stampuar "Albania" një ironi e hollë që askush nuk merr mundimin ta zhbëjë. Dhe kështu kthehem tek miku im dhe tek "Gota". Ai shqetësohet se unë e shoh bosh. Unë shqetësohem se dikush përpqet ta quajë plot.

Duke qenë se nuk më pëlqen të flas me përshtypje, por me fakte vendosa të bëj një numërim të thjeshtë, duke ecur kalldrëmeve.

Në Pazarin e Gjirokastrës gjenden rreth 140 njësi tregtare (përfshirë edhe ato pas Ndërtesës së Qarkut). Prej tyre, me gishtat e dorës mund të numërosh

Sepse, nëse nga 140 njësi vetëm 8-9 kanë lidhje reale me artizanatin, atëherë kemi më pak se 6% traditë dhe mbi 90% tregeti.

Por, përtej shifrave, problemi është më i thellë.

Pazari i Gjirokastrës nuk është thjesht një hapësirë për të shitur zhele të lira lindore. Ai duhet të jetë një institucion i kujtesës, një vend ku zanatet nuk ekspozohen si relike, por jetojnë si profesione.

Gota është bosh, pasi formula e administrimit të Pazarit, e cila ka dëshmuar se është një dështim i madh, edhe pse ka mbështetjen e Fondit Shqiptaro-Amerikan (AADF), që ka krijuar një lloj bordi administrimi me emrin TID.

TID, të dashur miq që lexoni, operon edhe në Pazarin e Korçës dhe të Tiranës, ku, as më pak e as më shumë, janë "tregje" me mallra vulgare dhe pa asnjë lidhje me traditën e njohur të artizanatit shqiptar.

Ky TID i Fondit Shqiptaro-Amerikan, i mbështetur edhe nga bashkitë respektive, por edhe nga Ministria e Turizmit dhe Kulturës, të cilat kanë detyrë jo vetëm funksionale, por edhe morale, duhet të krijojë hapësirën dhe mbështetjen për lulëzimin e artizanatit shqiptar.

Ndërkohë që TID shitet si sukses, në thelb nuk prodhohet asgjë në fushën e administrimit.

As artizanë të rinj. As shkolla zanatesh.

As një ide e vetme serioze për të kthyer turizmin në vlerë monetare për vendasit.

Dhe kjo është ndoshta ironia më e madhe, ndërsa turistët shtohen në Pazar, autenticiteti tradicional pakësohet.

Në një vend me pak fantazi, kjo do të ishte një mundësi e artë,

të hapeshin shkolla artizanati, të tërhiqej rinia, të krijohej një markë e vërtetë "Made in Albania", që të mos ishte vetëm një etiketë, por edhe një vlerë e madhe ekonomike për qytetin. Do të mjaftonte pak dashuri dhe pak vullnet.

Por, siç ndodh shpesh, Ministria e Turizmit dhe Kulturës, AADF, bashkitë dhe të tjerë kanë zgjedhur zgjidhjen më të lehtë, Fasadën.

Dhe kështu, për ta mbyllur bisedën me mikun tim.

Po, i dashur mik, Gota nuk është bosh por ka disa pika uji në fund të saj.

Por kur një pazar historik si i Gjirokastrës, që duhet të jetë Burim, kthehet në një curril vere me pika, atëherë nuk kemi të bëjmë me një gotë gjysmë bosh.

Kemi të bëjmë me një gotë që askush nuk do ta mbushë

DITMIR BUSHATI

Kjo pyetje shtrihet teksa jetojmë në një periudhë tranzicioni dhe transformimi të thellë gjeopolitik, ku normat e rendit të deridjeshëm, prej të cilit ne shqiptarët përfituam, po shpërfillen gjithnjë e më shumë. Bota nuk është më e parashikueshme. Politika e forcës është rikthyer dhe siguria është sërish në qendër të çështjeve ndërkombëtare.

Shtetet, pavarësisht nga madhësia e tyre, kanë kohë që debatojnë së brendshmi në rrafshin politik, akademik e shoqëror për pasojat e kësaj situatë. Historia na tregon se pasi një rend vendoset, ai qëndron për njëfarë kohe. Pas Luftës së Parë Botërore, rendi zgjati dy dekada. Rendi tjetër që u vendos pas Luftës së Dytë Botërore, zgjati katër dekada. Ndërkohë që pas rënies së Murit të Berlinit politologë si Francis Fukuyama flisnin për “fundin e historisë” dhe përfaqimin e demokracisë liberale si forma përfundimtare e qeverisjes.

Tri dekada pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, po jetojmë fundin e fundit të historisë. Një rend tjetër është në formim e sipër. Edhe nëse pasojat nuk ndihen ende kudo, shpërbërja e rendit botëror është tashmë një realitet i hidhur.

Dhe pikërisht aty qëndron rreziku, sepse efektet fillimisht shfaqen ngadalë, pastaj përshkallëzohen gjithnjë e më shpejt. Rivaliteti për energjinë, teknologjinë, zinxhirët e furnizimit me ushqim, industrinë dhe financat është intensifikuar. Kushdo që pret një kthim të shpejtë në normalitet, po humbet kohë të çmuar. Situata në të cilën ndodhemi ngjason me një cunami, ku valët nuk janë menjëherë të dukshme.

Megjithatë, kjo periudhë tranzicioni ka disa karakteristika. Karakteristika e parë është çarja e Perëndimit dhe e aleancës transatlantike. Perëndimi mbetet një ideal normativ i vlefshëm, por aktualisht ai nuk ekziston si një realitet politik. Ekzistenca e polit të fuqishëm të SHBA-ve mbetet, ndonëse me fuqi më të kufizuar se në dy dekadat që pasuan rënien e Murit të Berlinit. Karakteristika e dytë është pozicionimi i Kinës si kujdestare e rendit botëror, e cila ka potencialin më të madh për të sfiduar dominimin amerikan. Dallimet midis Kinës dhe SHBA-ve nuk janë vetëm politike, ushtarake dhe ideologjike, por shtrihen në fusha të shumta, nga teknologjia te planet dhe projektet e mëdha ndërkombëtare.

Krahas karakteristikave të viteve të para të shekullit të XXI, siç është ekzistenca e polit të vetëm, si dhe të shekullit të XX, siç ishte konkurrenca midis dy superfuqive, sot mund të dallojmë edhe një karakteristikë të tretë, që të kujton shekullin e XIX, për shkak të mirëkuptimit të pjesshëm të fuqive të mëdha për të toleruar në

A KA SHQIPËRIA NJË POLITIKË TË JASHTME?



mënyrë të heshtur shkeljen e rregullave të së drejtës ndërkombëtare. Sado i vogël e i papërfillshëm të jetë një shtet në arenën ndërkombëtare ai e ka të nevojshme pasjen e një strategjie në politikën e jashtme. Kjo bëhet edhe më e domosdoshme në këtë periudhë tranzicioni.

Tri janë shtyllat që formësojnë karakterin e politikës së jashtme: vlerat, interesat dhe fuqia. Këta tri elemente janë thelbësore kur ekuilibri dhe dinamika e rendit botëror ndryshojnë. Në rastin tonë janë të vlefshme vetëm dy të parat, pasi fuqia është një luks i lojtarëve më të mëdhenj. Ata mund të projektojnë pushtet ushtarak dhe ekonomik, duke i detyruar lojtarët më të vegjël të linjëzohen me qëllimet e tyre.

Ndërkohë, aleancat, grupimet dhe diplomacia e zgjuar janë ato që i japin një lojtarit të vogël ndikim përtej madhësisë së ekonomisë apo ushtrisë që posedon. Për Shqipërinë, një nga sfidat në politikën e jashtme është ruajtja e koherencës dhe qëndrueshmërisë në raport me vlerat që mbrojmë dhe interesat që kemi, duke ruajtur njëkohësisht aleancat me partnerët strategjikë. Kjo kthehet në domosdoshmëri, sidomos në një kohë të pasigurt kur referencat ndryshojnë vazhdimisht.

Ndërsa interesat dhe aspiratat tona përbëjnë horizontin e politikës së jashtme, vlerat dhe qëndrueshmëria e tyre duhet të jenë vija përcaktuese të horizontit.

Çarja transatlantike nuk është një ogur i mirë për Shqipërinë dhe rajonin tonë, ku që prej rënies së perdes së hekurt, SHBA të shihen si garantues

të perimetrit të sigurisë, ndërsa europianët si ‘alergjikë’ ndaj përdorimit të forcës. Sikurse dihet, BE-ja është një projekt që e ka gjenezën e vet në mbështetjen amerikane pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Sot mosmarrëveshjet midis SHBA-ve dhe BE-së janë më të mëdha se kurrë.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare të SHBA-ve është pasqyrim i këtij realiteti, ku BE-ja përshkruhet si shkaktare e “shuarjes së civilizimit evropian”. Formësimi i rendit të ri botëror dhe pozicioni që do të ketë aleanca transatlantike do të përcaktohen në një të ardhme jo të largët. Shtete si Shqipëria nuk janë as lojtarë kryesorë dhe as spektatorë në këtë histori.

Pasiguria është pjesë e marrëdhënieve ndërkombëtare, sidomos gjatë tranzicioneve nga një epokë në tjetrën. E rëndësishme është të kuptohet pse po ndodh ndryshimi dhe si të reagohet ndaj tij. Veprimi ynë bazuar në vlera dhe interesa do të na krijojë hapësirën e nevojshme për të lundruar në këtë epokë të re të marrëdhënieve ndërkombëtare. Raporti ynë me SHBA-të është i pazëvendësueshëm. Po kaq e rëndësishme është që ne të mos e shpërdorojmë mundësinë për anëtarësim në BE, të krijuar si pasojë e situatës gjeopolitike. Luftërat e njëkohshme në Ukrainë dhe Lindje të Mesme, që janë shoqëruar me çarje të aleancës transatlantike kanë shpërfaqur një tipar kameleonik të politikës sonë të jashtme.

Nuk e di se sa të vlefshme janë propozimet për të dialoguar me Putinin, në kushtet kur ishim po ne që si bashkëpunëmbajtës me SHBA-të në

Këshillin e Sigurimit të OKB-së për çështjet e lidhura me Ukrainën, spikatëm për qëndrimin kritik, përtej gjuhës diplomatike, kundër agresionit rus.

Çfarë ndikimi mund të ketë ky propozim për rajonin tonë dhe përmbylljen e konflikteve të shtetësisë? Sa serioz është ky propozim kur qëndrimet e udhëheqësve kryesorë europianë, që deri dje janë kritikuar për një qasje të butë ndaj Rusisë, sot vendosin theksin tek ndërtimi i arkitekturës europiane të sigurisë kundër agresionit rus?

Po kështu, nevoja për të bërë dallimin mes nesh dhe vendeve të tjera europiane, për sa i përket pranisë së Shqipërisë në Bordin e Paqes, është jo produktive. Ne jemi në vendin ku na takon të jemi, përkrah SHBA-ve, sa herë që kontributi ynë çmohet i vlefshëm. Ndonëse në një format, kohë dhe kontekst tjetër gjeopolitik, kemi qenë pjesë e koalicionit të udhëhequr nga SHBA-të në luftën në Irak, edhe pse një pjesë e mirë e aleatëve europianë hezituan apo ishin kritikë me të. Propozimi i pakërkuar për të kryer operacione ushtarake kundër Iranit nga territori i Shqipërisë, në kushtet e mungesës së bazave amerikane ushtarake, vendos pikëpyetje mbi besueshmërinë e propozimit.

Ai mund të lexohet edhe si sfidë ndaj aleatëve europianë, të cilët, edhe pse kanë baza ushtarake amerikane, nuk iu përgjigjen thirrjeve të presidentit të SHBA-ve.

Cili është interesi i propozimeve të tilla? E shtroj këtë pyetje pasi interesi udhëheq zgjedhjet që bëjnë shtetet

dhe kjo është plotësisht legjitime. Interesi ynë është të jemi përkrah SHBA-ve, por duhet të kemi peshën që na mungon për të ndërmarrë angazhime të tilla.

Gjithashtu, është pak por e sigurt të thuhet se fati i konkurrencës amerikano-kineze nuk do të vendoset në Shqipëri. Ndaj, duhet të shmangim çdo retorikë që do t'i vendoste përballë këta dy aktorë, përkundërt realitetit shqiptar. Në politikën e jashtme, qëndrueshmëria është një komponent thelbësor i besueshmërisë. Të kuptohemi, Shqipëria është një vend i vogël që nuk ka në dorë zgjidhjen e çështjeve të ndërlikuara ndërkombëtare. Por që të veprojmë me seriozitet dhe të demonstrojmë qartësi strategjike është detyrimi ynë.

Të tilla çështje kërkojnë drejtpeshimin e interesave dhe vlerave që kemi promovuar ndër vite, pasi në lojë është pjekuria dhe vazhdimësia e shtetit, aftësia për t'u orientuar siç duhet në një botë që ndryshon vazhdimisht. Gjithashtu, shqetësuese është humbja e një prej asetëve kryesorë të politikës sonë të jashtme: pesha dhe influenca tek shqiptarët në rajon. E cila, nuk mund të rikuperohet me organizimin e takimeve mbarëkombëtare në Tiranë.

Raportet dhe miqësitë personale që synojnë të mbajnë në këmbë një rrjet të fosilizuuar nga koha e gjatë e qëndrimit në pushtet, instrumentalizimi i interesit kombëtar për nevojat e politikës së ditës, gara e pakuptimtë, në mungesë të bashkëveprimit, mes Tiranës e Prishtinës për influencë mes shqiptarëve në rajon, kanë dobësuar ndjeshëm fuqinë përcaktuese të shqiptarëve dhe njëkohësisht ritmin e përparimit të të drejtave që duhet të gëzojnë.

Përqendrimi i energjive për të normalizuar marrëdhëniet me Serbinë, është shoqëruar me dobësimin e rolit udhëheqës të faktorit shqiptar në rajon. Kam qenë dhe jam në mbështetje të normalizimit të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Serbisë. Por këto marrëdhënie nuk mund të ndërtohen në shpërfillje të historisë, gjeografisë dhe realitetit në rajonin tonë.

Nuk e kam kuptuar asnjëherë pozicionin e Shqipërisë, që nga njëra i kërkonte publikisht BE-së “të mos ushtronte presion ndaj Serbisë për t'iu bashkuar sanksioneve ndaj Rusisë”, dhe nga ana tjetër, pezulloi takimet e përbashkëta qeveritare me Kosovën, për shkak të masave shtërnguese që padrejtësisht BE-ja vendosi ndaj Kosovës.

Mbetet e pashpjegueshme se përse qëndrimet e kryeministrit në Asambleen Parlamentare të Këshillit të Europës dhe Bordin e Paqes, ndaj Dhomave Speciale të Kosovës në Hagë, sikundër rezolutat dhe

deklaratat e Kuvendit të Shqipërisë nuk përkujnë me qëndrimet dhe veprimet e politikës sonë të jashtme.

Shqipëria, në mënyrë të përsëritur i është bashkuar deklaratës së BE-së në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për “rëndësinë dhe nevojën e mbështetjes të punës së Dhomave Speciale të Kosovës”, edhe pse kjo nuk është një çështje e politikës së përbashkët të sigurisë dhe asaj të jashtme, të cilën, BE-ja e shqyrton në kuadër të linjimit nga ana e vendeve kandidate.

Kujt i shërbejnë iluzionet e rrejshme kur jo vetëm politika e brendshme nuk reflektohet në atë të jashtme, por as deklarimet në forume ndërkombëtare nuk përkthehen në qëndrime e veprime të politikës së jashtme?

Gjuha e papranueshme e përdorur ndaj shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut është simptomë e një politike që herë karakterizohet nga paternalizmi e herë nga indiferenca, shoqëruar me mungesën e ndjeshmërisë për sakrificat e shqiptarëve për t'u trajtuar si të barabartë me maqedonasit.

Platforma e partive politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut e vitit 2017, e mbështetur nga Shqipëria, bazohej mbi parimin e përparimit të të drejtave të shqiptarëve dhe barazisë me maqedonasit. Kjo platformë arriti të prodhojë disa suksese pikërisht sepse politika jonë e jashtme ishte e përqendruar në përmbushjen e objektivave të lidhura me interesin kombëtar dhe jo me fatin politik të partive e individëve të caktuar.

Përfshirja pa asnjë arsye të qenësishme në një cikël replikash me Bull-



garinë, në lidhje me mosmarrëveshjet e saj me Maqedoninë e Veriut, po reflektohet në kërkesat e Bullgarisë ndaj Shqipërisë në procesin e zgjerimit.

Nuk duhet të habitemi, pasi shtetet dhe diplomacia veprojnë në mënyrë të ftohtë e të llogaritur. Historia dhe gjeografia janë dy komponentë që nuk mund të ndryshohen në politikën e jashtme. Askush nuk i zgjedh fqinjët. Për këtë arsye është thelbësore të bëhen të gjitha përpjekjet për të bashkëjetuar me ta.

Shqipëria duhet të ketë një strategji të nivelit të lartë dhe afatgjatë për të adresuar çështjet me Greqinë, si fqinji më i zhvilluar në Ballkan.

Një strategji që duhet të mbështetet tek vlerat dhe interesat e vendit, duke i trajtuar çështjet dypalëshe në tërësinë e tyre. Sa herë ndryshon ministri i jashtëm është bërë zakon të flitet për një “fillim të ri” në marrëdhëniet me Greqinë. E vërteta e hidhur është se asnjë hap nuk është hedhur në këtë drejtim, që prej vitit 2018. Gabimisht, Shqipëria ka mbivlerësuar përfitimet afatshkurtra duke mos llogaritur humbjet afatgjata. Pas një procesi shumëvjeçar diskutimesh e negociatash, në vitin 2018, ne ishim pranë një kompromisi historik me Greqinë.

Them historik, pasi do të mbylleshin njëherë e mirë të gjitha çështjet e pazgjidhura mes nesh në mënyrë të drejtë. Ndoshta as Shqipëria e as Gre-

qia nuk ishin gati për këtë kompromis. Sot mund të jenë pjekur kushtet. Ndaj, duhen zgjidhje të drejta dhe të qëndrueshme në tërësi e jo adresim i çështjeve në mënyrë selektive.

Në këtë këndvështrim, do të ishte gabim të veçohet çështja e detit nga paketa e çështjeve të pazgjidhura me Greqinë.

Njoftimi i ministrit të jashtëm për ta referuar zgjidhjen e kësaj çështjeje në një gjykatë ndërkombëtare brenda vitit, nëse bëhet pa kushte dhe përgatitje paraprake, rrezikon të përsërisë gabimet e vitit 2009. Që vendi të shkojë në gjykatën ndërkombëtare nuk mjafton kontraktimi i kompanive avokatore të huaja.

Vendi duhet të ketë përgatitjen e duhur, në raport me jurisprudencën ndërkombëtare, të ketë kryer “detyrat e shtëpisë” dhe të ketë nxjerrë konkluzionet nga gabimet e vitit 2009 dhe arritjet e vitit 2018. Pasi nuk kemi të bëjmë me transferim të përgjegjësi për mënyrën e adresimit të kësaj çështjeje, por me shprehjen e gatishmërisë së palëve ndërgjyqëse për të pranuar verdiktin e gjykatës ndërkombëtare.

Thënë ndryshe, vendi duhet të ketë aftësinë për të kryer tri detyra: kuptimin e plotë të precedentëve të krijuar nga drejta ndërkombëtare e detit, përpunimin e thelluar të zgjidhjeve alternative në respekt të jurisprudencës kushtetuese dhe formulimin e një strategjie për zbatimin e më të dobishmes prej tyre.

Trajtimi i problemeve të vështira të politikës së jashtme kërkon strategji, kohë dhe durim. Ky mësim nuk ka të bëjë me fatalizmin apo shmangien e zgjedhjeve të vështira.

Ka të bëjë me atë që mund të arrihet me një kosto të pranueshme në krahasim me prioritetet e tjera, si të jashtme ashtu edhe të brendshme. Përsosmëria rrallë është në menyne diplomaci, veçanërisht në ditët e sotme.

Për të perifrashuar Henry Kissinger, shtetari nuk e ka luksin e analistit në politikën e jashtme, pasi atij problemi i imponohet, koha për të gjetur zgjidhjen e duhur nuk mjafton asnjëherë dhe zgjidhja e gabuar nuk rikuperohet. Dhe për më tepër, suksesi i vendimmarrjes i nënshtrohet gjykimit të historisë.

Dotech

website

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

The Albanian

KRIJO WEBSITIN TËND

MOS RRI ANONIM

Me mijera klientë mund të jenë të intersuar për biznesin tuaj, por mbase nuk e dijnë që ti ekziston...



Për çdo konsultim mund të vini në zyrat tona

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT

Dotech
websites

☎ 020 7018 7929

☎ 078 5997 7545

☎ 073 4066 5946

Si po lëviz e po kthehet në vend të vetin për të lëvizur sërish harta e jezuitit Matteo Ricci

VETON SURROI

1.

Kryeministri spanjoll, Pedro Sanchez, mbajti një fjalim të rëndësishëm në një universitet kinez muajin e kaluar. Fjalimi u ndërtua rreth boshtit të rrefimit kur më 1583 “një jezuit italian i quajtur, Matteo Ricci, mbërriti në Kinë. Në bagazhin e tij të vogël, ai sollí me vete disa libra, një astrolab dhe një hartë të botës.

Ishte një hartë evropiane. E saktë në përmasa, shumë e avancuar në nivelin e detajeve, por e anshme në perspektivën e saj. Sepse ajo që bënte ishte të tregonte botën ashtu siç e shihte Perëndimi: me Evropën në qendër dhe Azinë në skajin e saj të djathtë. Në skajet e tokës. Me ta parë, kartografët e oborrit perandorak e pyetën jezuitin pse Kina shfaqej pikërisht në skajin e hartës.

Dhe studiuesi evropian e kuptoi për herë të parë se Deti Mesdhe ishte qendra e botës së tij, por jo e të tjerëve. Çdo botë kishte qendrën e vet, prandaj Matteo Ricci e rivizatoi plotësisht hartën e tij. Këtë herë, duke përdorur Oqeanin Paqësor si boshtin e tij dhe duke përfshirë të gjithë kontinentin euroaziatik brenda tij”.

Kjo pjesë e fjalimit mbase përshkruan në formë më të kondensuar lëvizjen e madhe gjeopolitike (apo njëri prej lëvizjeve tektonike) nëpër të cilën po kalon bota jonë, diçka që Z.Brzezinski kishte paralajmëruar që në fillim të këtij shekulli, pra që pesha e historisë po zhvendoset në Lindje, me një Kinë që arrin forcën e superfuqisë.

2.

Kjo është një formë e kundërimit. Pra, që të marrim parasysh peshën e rritur të Kinës dhe të zhvillimit të Azisë në përgjithësi, e ta shikojmë botën prej persektivës ku, siç kishte rivizuar Ricci, Paqësori është boshti e ne, mesdhetarët, jemi pjesë të kontinentit euro-aziatik.

Mes dy hartave të Riccit, asaj ku Mesdheu (Mediterra-mesi i Tokës) është boshti dhe asaj ku Paqësori është boshti, ekziston një realitet i ndërmjetmë, mendoj unë ose kam qejf të mendoj unë.

Pra, ekziston një realitet i ndërmjetmë në të cilin është e qartë se Kina është fuqi tashmë e arrirë (jo në rritje, siç konsiderohej gjatë çerekut të parë të shekullit), por është po ashtu e qartë se ky fakt si dhe fakti që fuqia tjetër përballë saj është SHBA-ja, nuk do të thotë që jetojmë në një botë të diktuar

USHTRIME MENDORE PËR POLIKRIZA, NGA NJË VEND MESDHEU



nga baraspesha mes këtyre dy superfuqive.

Në fakt jetojmë në botë ku nuk ka baraspeshë, pra në një realitet pa ekuilibër, në një botë pa rend të ri ndërkombëtar. Dhe, ai rend i ri ndërkombëtar do të marrë parasysh, nuk do mend, peshën e dy superfuqive, por do marrë parasysh edhe peshën e fuqive të mesme, siç i quan kryeministri kanadez, Mark Carney, vendet si i veti dhe të tjerë (Afrika e Jugut, Brazili etj).

Sipas Carneyt, rendi i ri ndërkombëtar, për më tepër, nuk duhet të jetë akt i nënshtrimit një bote të izoluar dhe transakionale dhe se “mund të rindërtohet nga Evropa”.

3.

Evropa për të cilën Carney mendon se mund të prodhojë një rend të ri ndërkombëtar mund të kuptohet nga vendi ku foli, Samiti i Komunitetit politik evropian. Samiti, një ide e presidentit francez, Macron, në formë të suksesshme po i tejkalon kufijtë e ngushtë të konceptit të politikës evropiane të përcaktuar nga ai tradicionalisht BE me rrethinë. Në rathë koncentrikë që kanë përfshirë Turqinë dhe vendet që nuk njihen mes vete si Kosova e Qipro apo Spanja, samiti i

sivjetmë u mbajt në Armeni dhe e ftuar e Samitit ishte Kanadaja. Kështu Evropa mendore, pra hapësira politike evropiane shtrihet nga Kanadaja në Kaukaz.

Ky ushtrim mendor në një mënyrë paradoksale kthen hartën e parë të Riccit; kur Evropa mendore shtrihet prej Kanadasë në Kaukaz Mesdheu merr më shumë nga pesha e tij simbolike. Dhe për më tepër e merr peshën e vet vlerore, atë të konceptualizimit të rendit të ri botëror. Mesdheu është vendlindja e “agoras”, të sheshit publik në të cilin peshohen argumentet e debatit të lirë për të marrë vendim të njerëzve të lirë, pra demokraci.

Dhe, Samiti i Komunitetit politik evropian në Yerevan kishte për mua këtë peshë specifike, atë ku Carney dhe liderët e tjerë evropianë konceptualizojnë rendin e ri botëror në një debat të njerëzve të lirë e të barabartë.

Duket gjë e lehtë kur ta thuash, por në nivel global nuk ekziston një tubim i këtij lloji të shefave të shteteve a qeverive në të cilat niveli i debatit nuk është akt protokollar, por ushtrim analitik intelektual.

4.

Gjendja e dallimit mes njëres hartë gjeopolitike, të parës së Riccit dhe

asaj që do të prodhohet nga rendi i ri ndërkombëtar ka një emër, që ia vuri kryeministrja italiane, Melloni, polikriza. Sipas saj, jetojmë në kohë jo të një krize, por kur disa kriza njëkohësisht janë në ndërveprim - që nga migracioni, siguria energjetike, veprime dashakeqe me inteligjencë artificiale, rrënim i besueshmërisë në demokraci e kështu me radhë. Rrjedhimisht, do adresuar “polikrizën” si tërësi.

Adresa është gjithnjë një veprim më i mirë i Evropës. Qoftë BE-së së bashku me rrethin e saj apo të Evropës mendore apo të një Evrope të fuqishme me aleancat e veta të tregjeve të hapura nga Amerika Latine në Indi (siç do të shpjegojë presidentja e Komisionit evropian, U. van der Leyen).

Apo, siç do të shpjegojë në formë praktike presidenti francez, Macron. Sipas tij, sfida e ardhshme do të jetë largimi nga varshmëria prej SHBA-së dhe Kinës.

Varshmëria nga SHBA-ja nënkupton atë të ombrellës amerikane të mbrojtjes, me të cilën është mësuar Evropa që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Varshmëria nga Kina nënkupton atë të teknologjisë me të cilën është mësuar Evropa që nga fundi i Luftës së Ftohtë.

5.

Në Yerevan Komuniteti politik evropian u përpoq të dëshmojë se ndonëse nuk është në qendër, si të harta e parë e Riccit, nuk është në periferi, as gjeografike e as politike. Për më tepër, në samitin para këtij kufijtë e këtij komuniteti ishin Britania e Madhe në Perëndim e Ukraina në lindje; këso here në perëndim ishte Kanadaja e në lindje Armenia. Kanadaja si “fuqia e mesme” e cila duhet të gjejë një modus vivendi me SHBA-në e Armeninë, një pikë e rëndësishme strategjike e cila duke u shkëputur nga Rusia bëhet pjesë e një korridorit të rëndësishëm energjetik, ndaj edhe gjeostrategjik prej Detit Kaspik në atë Mesdhe.

Kështu e pashë këtë Samit nga këndi i vëzhguesit, në Kosovë, në thellësi mesdhetare e paradoksalisht në margjina të Evropës.

Në këtë thellësi, larg qendrave të vetëshpallura të botës, ndoshta kuptohet më qartë se harta e Riccit nuk është më çështje gjeografie, por e kapacitetit për të prodhuar rend: kush arrin ta konceptualizojë dhe ta organizojë përgjigjen ndaj polikrizës, ai e vendos veten në qendër.

EKSPERTËT BRITANIKË PËR RAPORTIN MBI SPECIALEN: VË NË PAH PENGESAT PËR LIRIMIN NGA PARABURGIMI DHE PABARAZINË QË DËMTON MBROJTJEN

Komiteti për të Drejtat e Njeriut i Odës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit (BHRC) ka bërë të ditur se ka publikuar raportin të iniciuar me kërkesë të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, i cili ofron një vlerësim paraprak të pavarur të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK), i ndërmarrë për të vlerësuar shkallën në të cilën kjo gjykatë përputhet me standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut.

I realizuar me një theks të qëllimshëm mbi pavarësinë pa input nga institucioni kërkuar shqyrtimi përdor një metodologji doktrinare dhe të bazuar në analizë dokumentare, të mbështetur në burime primare juridike, jurisprudencë dhe angazhim të informuar me praktikues të fushës, bëhet e ditur në njoftim.

Ndonëse paraqitet shprehimisht si një ushtrim “paraprak”, raporti identifikon një sërë temash themelore që janë qendrore për legjitimitetin e drejtësisë penale ndërkombëtare bashkëkohore, përfshirë të drejtat e të akuzuarve, pavarësinë gjyqësore, drejtësinë provuese dhe barazinë e armëve.

Në këtë mënyrë, ai e vendos DhSK-në si brenda rendit kushtetues të Kosovës, ashtu edhe brenda kornizës më të gjerë ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat janë të inkuorpuara drejtpërdrejt në legjislativin e Kosovës.

Raporti gjithashtu e kontekstualizon themelimin e DhSK-së brenda trashëgimisë politike dhe historike të kontestuar të konfliktit të Kosovës të viteve 1998–1999 dhe pretendimeve të mëvonshme për krime të kryera nga anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ai thekson natyrën sui generis të gjykatës: formalisht një institucion



vendor i krijuar sipas ligjit të Kosovës, por i përbërë nga gjyqtarë ndërkombëtarë, i financuar dhe i ndikuar nga aktorë ndërkombëtarë, dhe me seli në Hagë. Ky dizajn hibrid dhe, në disa aspekte, kontradiktor nga brenda, krijon sfida të veçanta, sidomos në lidhje me legjitimitetin, llogaridhënien dhe raportin ndërmjet standardeve ndërkombëtare dhe traditave juridike vendore.

BHRC thekson se fokusi i ngushtë i DhSK-së ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së, përbërja ekskluzivisht ndërkombëtare e trupit gjykues dhe mbështetja në mekanizma të jashtëm financimi dhe emërimi janë bërë burime të vazhdueshme polemikash, duke ngritur pyetje si për perceptimin, ashtu edhe për realitetin e pavarësisë dhe paanshmërisë.

Në këtë sfond, raporti paraqet një grup të strukturuar vëzhgimesh para-

prake mbi aspektet kyçe të kornizës juridike dhe praktikës së DhSK-së, përfshirë lirinë e përkohshëm, pavarësinë gjyqësore, pranueshmërinë e provave dhe barazinë e armëve.

Ai konstaton se, ndonëse korniza formale juridike e gjykatës është përgjithësisht solide dhe në shumë aspekte në përputhje me normat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, shqetësime të rëndësishme lindin në funksionimin e saj praktik. Këto përfshijnë pengesa strukturore për lirinë e përkohshëm, mangësi në mekanizmat për kundërshtimin e emërimeve gjyqësore dhe vendimeve administrative, tensione të krijuara nga praktikatat provuese (veçanërisht lidhur me materiale të patestuara ose të siguruar nga burime të jashtme), si dhe pabarazi burimore dhe procedurale që ndikojnë mbrojtjen.

Raporti nuk pretendon të arrijë përfundime përfundimtare, por identifikon fusha me rrezik potencial dhe rekomandon shqyrtim të mëtejshëm, duke theksuar se legjitimiteti afatgjatë i DhSK-së do të varet jo vetëm nga respektimi formal i standardeve juridike, por edhe nga aftësia e saj për t'i realizuar vazhdimisht ato standarde në praktikë.

Në dritën e këtyre gjetjeve, raporti paraqet një sërë rekomandimesh të synuara për forcimin e drejtësisë, transparencës dhe legjitimitetit institucional të DhSK-së. Ndër më kryesoret janë propozimet për ndryshimin e kornizës procedurale në mënyrë që të lejohet kundërshtimi kuptimplotë i funksioneve administrative dhe gjyqësore të Presidentit, si dhe vendosja e protokolleve të qarta që rregullojnë komunikimet – siç janë informimet diplomatike – për të garantuar njoftim, zbulim të informa-

cionit dhe, kur është e përshtatshme, pjesëmarrjen e mbrojtjes.

BHRC rekomandon gjithashtu kontroll më rigoroz gjyqësor të materialeve provuese, veçanërisht kur kontestohet origjina ose zinxhiri i ruajtjes së tyre, së bashku me transparencë më të madhe lidhur me marrëdhëniet me shtetet financuese dhe aktorë të tjerë të jashtëm.

Në fund, raporti thekson nevojën për monitorim të vazhdueshëm dhe të pavarur të gjykimeve, duke e konsideruar atë thelbësor për vlerësimin e ndikimit kumulativ të praktikave procedurale — sidomos në raport me barazinë e armëve dhe drejtësinë provuese — dhe për të siguruar që DhSK-ja të përmbushë standardet e larta të drejtësisë të kërkuara si nga korniza kushtetuese e Kosovës, ashtu edhe nga drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut.

Dotech
website

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

BUSINESS CARDS

BANNERS

POSTERS



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT



Dotech
website

**190 Merton High Street
Wimbledon
London SW19 1AX**



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



Ne mund t'ju ndihmojmë

- **Asylum & Immigration**
- **New Point Based System**
- **Settlement Applications (ILR)**
- **European Law**
- **Nationality & Travel Document**
- **Human Rights Applications**
- **High/Court of Appeals**
- **Over Stayers**
- **Work Premits**
- **Visa Extensions**
- **Judicial Reviews**
- **Tribunal Appeals**



Konsultimet falas



07774222062



07878335000

TEL: 0208 5401 666

TEL: 0208 672 0666

